

Udhëheqësia Politike e re e Kosovës



Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit
të Kosovës

Editoriali

Kosova ka një udhëheqësi të re. Brenda një muaji u zgjodhën Presidenti i ri, Kryeministri i ri dhe Kryetari i ri i Kuvendit. Kështu, Fatmir Sejdiu u zgjodh President i Kosovës pas vdekjes së Presidentit Ibrahim Rugova. Ish Komandanti i TMK-së Agim Çeku e morri detyrën e Kryeministrit pas dorëheqjes së Bajram Kosumit nga ky post. Ndërsa, ish nënkryetari i LDK-së Kolë Berisha u zgjodh Kryetari i Kuvendit në vend të Nexhat Dacit. Së këndejmi, tani edhe delegacioni i Kosovës për bisedime rreth statusit ka përbërje të re. Me 24 mars Kuvendi zhvilloi një debat të gjerë rreth bisedave për status, duke u përqendruar në dy rrethet e para të bisedimeve për decentralizimit.

S'do mend se ne shpresojmë se debati do të sjellë vendosjen e një modeli të punës, i cili do të bëjë të mundur që të mbahen më dendur seanca plenare rreth çështjeve të ndryshme në Kosovë. Kryetari i ri i Kuvendit, z. Kolë Berisha, ka për qëllim jo vetëm që të sjellë në Kuvend një atmosferë të re dhe demokratike por edhe ta thellojë bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare. Ndërsa, ndër prioritet kryesorë për të janë transparenca dhe respektimi në tërësi i Rregullores së Punës.

Njëherësh, ne mbetemi me shpresë se ndryshimet e fundit në Kuvend do të bëjnë të mundur që Kuvendi, në përgjithësi dhe grupet parlamentare dhe komisionet, në veçanti do ta avancojnë rolin e tyre jo vetëm në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë por edhe atë të mbikëqyrjes financiare të shpenzimeve të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK-së). Ngase dihet mirëfilli se këto janë çështjet kryesore për përmbushjen e standardeve të qeverisjes së mirë. Do thënë se veç këtyre, ka mjaft sfida edhe në administratën e Kuvendit, të cilat paraqesin një rast të mirë për riafrimimin (konfirmimin) e respektimit të plotë të rregullave ekzistuese.

Ky edicion i Buletinit Informativ të ASI-it bën fjalë për udhëheqësin e re të Kosovës, dhe përqendrohet në çështje të veçanta dhe me interes nga sfera ligjore dhe e politikave, të cilat janë prezantuar dhe shpalosur kryesisht përmes vështrimeve.

Në këtë artikull, z. David Payne nga Instituti Nacional Demokratik (NDI) shpalos pikëpamjet e tij rreth "kohës së rezervuar për pyetje", gjatë së cilës ministrave u parashtrohen pyetje në Kuvend. Ndonëse disa çështje tanimë janë inicuar në Kuvendin e Kosovës, megjithatë mund të bëhet edhe më tepër. Z. Ferid Agani, kryesues i grupit parlamentar "Për Integrim", në artikullin e tij bën fjalë për krijimin e grupit shumë-partiak dhe shumë-etnik, i cili ka për qëllim të luajë një rol aktiv në veprimtarinë legjislative të komisioneve të Kuvendit. Ndërsa, znj. Gjylnaze Sylja, kryesuese e grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në shkrimin e saj përqendrohet në iniciativën e re për krijimin e zyrës për marrëdhënie me zgjedhësit në njërin nga qytetet e Kosovës.

Këta tre artikuj reflektojnë mbi tri funksionet kryesore të Kuvendit: mbikëqyrjen e Qeverisë, miratimin e legjislacionit dhe komunikimin me votuesit. Në kohën kur Kosova po hyn në fazën më të rëndësishme të zhvillimeve politike, zhvillimet aktuale në Kuvend meritojnë një vëmendje të shtuar. Së këndejmi, tani është koha që të gjitha grupet politike ta promovojnë dhe thellojnë bashkëpunimin rreth çështjeve të rëndësishme për të ardhmen. S'ka pikë dyshimi se në këtë rrugëtim të përbashkët, OSBE-ja tok me partnerët e tjerë në "Iniciativën për Përkrahjen e Kuvendit" janë të vendosur që ta japin kontributin e tyre. Ky Buletin është dëshmia më e mirë për këtë.

*Franklin De Vrieze,
Koordinator i "Iniciativës për Përkrahjen e Kuvendit".*

Editoriali	2
Fjala përshëndetëse e z. Kolë Berisha me rastin e pranimit të detyrës së Kryetarit të Kuvendit të Kosovës	3
Presidenti Fatmir Sejdiu flet për BBC-në	6
"Nuk ka liri të plotë në Kosovë përderisa të gjithë qytetarët e Kosovës nuk e gëzojnë atë"	7
Liderët serbë të Kosovës takohen me Kryeministrin Çeku, për të diskutuar për kthimin e tyre në Qeveri	9
Zhvillimet e fundit në Kuvend	10
Të mësohemi ta dëgjojmë zërin e qytetarit	12
Kryesia e Kuvendit të Kosovës	14
Pse kërkuam dinamizimin e punës së Kuvendit	16
Vizion për Kosovën e pavarur	17
Koha për shlyerjen e hesapeve	18
Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Kosovës	19
Sfdat dhe përmirësimet në punën e Kuvendit të Kosovës	20
Rrugëtimi i Kosovës drejt integriteteve evropiane	22
Shqyrtimi i Draft Ligjit për Veteranët: OSBE-ja ofron mbështetje	23
Aspektet kryesore të "kohës së parashikuar për pyetje"	24
Prezenca e OSBE-së në terren	25
Përkthimi me shkrim/me gojë: Sfdat aktuale të përkthimit	26



Fjala përshëndetëse e z. Kolë Berisha me rastin e pranimit të detyrës së Kryetarit të Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës, 10 Mars 2006

Kolegë të nderuar deputetë,

Jam i vetëdijshëm se, duke ma dhënë besimin që prej sot t'i organizoj, t'i mbikëqyr, t'i koordinoj dhe t'i drejtoj punime dhe aktivitetet e tjera nga fushëveprimi i këtij Kuvendi, Ju, në fakt, me votën Tuaj sot ma keni dhënë një obligim të madh, më keni ngarkuar me një detyrë që kërkon mund, përgjegjësi dhe sakrificë.

Kosova tani ndodhet para muajve të saj vendimtarë, para ditëve të saj vendimtare dhe, do të thosha, edhe para orëve të saj, po ashtu, vendimtare.

Ne tashmë kemi hyrë në një fazë gjithësesi historike për Kosovën, për institucionet e saj të dala nga vota e lirë e qytetarit dhe për popullin, vullnetin e të cilit, të gjithë së bashku, por edhe me ndihmën e miqve tanë të shumtë, të prirë nga SHBA-të dhe vendet e Bashkimit Evropian, duhet ta çojmë deri në fund – deri në krijimin e një shteti të pavarur dhe sovran që do të jetë shembull për këtë pjesë të Evropës Juglindore ; të një shteti që do të jetë në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës – aleatin tonë më të madh, i cili dy herë, vetëm brenda një shekulli, në çastet më të vështira për ne, u gjend pranë nesh.

Para këtij Kuvendi, si njëri ndër mekanizmat më të rëndësishëm, në mos më i rëndësishmi, për bërjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran, shtrohen detyra shumë të mëdha.

Prandaj, në këto momente nëpër të cilat po kalojmë, edhe mbi partinë time të madhe, edhe mbi partitë tuaja, pak a shumë më të vogla në numër, është diçka që është shumë më e madhe, shumë më e shtrenjtë; është diçka që duhet të jetë mbipartiake, mbipersonale, mbigrupore, mbikonfesionale, mbigjinore; është kauza jonë e përgjithshme – Kosova shtet sovran dhe i pavarur; është e tashmja dhe e ardhmja e fëmijëve tanë dhe e fëmijëve të fëmijëve tanë.

Unë ju garantoj se, me tërë qenien time, do të angazhohem që kjo shtëpi e shenjtë, prej nga dolën dhe do të dalin aktet që përcaktojnë, që rregullojnë dhe që sanksionojnë sistemin politik, juridik, ekonomik dhe fushat e tjera të jetës në shtetin e Kosovës, të jetë tempull i fjalës së lirë të deputetit; të jetë zë i fuqishëm i pozitës dhe i opozitës, i shumicës dhe i pakicës. Pra, ky Kuvend do të jetë vend që promovon dhe thëllon të drejtat e barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallime etnike, politike, gjinore, fetare, etj.

Do të angazhohem që deputeti të ndjehet vërtet zot i kësaj shtëpie. Mua do të më duhet ndihma juaj. Unë ju garantoj se ju do ta keni ndihmën time.

Duke qenë njeriu i parë ndër të barabartët në këtë shtëpi, krahas përpjekjeve të pandërprera për krijimin e kushteve më të mira për punë normale dhe për zgjidhjen e problemeve eventual të secilit deputet veç e veç, dhe të gjithëve së bashku (natyrisht,



Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha

për aq sa lejojnë rrethanat aktuale), do të angazhohem maksimalisht që, në Kryesinë e Kuvendit, ndërmjet grupeve parlamentare, komisioneve dhe trupave të tjera të Kuvendit të Kosovës, të thellohet edhe më shumë ajo që për mua është më e rëndësishmja dhe, do të thoj, dhe bashkëpunimi, sepse vetëm kështu mund të ecim përpara.

Unë kujtoj se, rruga më e mirë për t'i arritur këto dhe objektivat e tjera, është zbatimi me përpikëri i Kushtetutës, i ligjeve dhe i akteve të tjera nënligjore, duke përfshirë këtu, edhe Rregulloren e punës së këtij Kuvendi. Popujt e civilizuar udhëhiqen nga normat e shkruara. Do të dijmë të dëshmojmë se edhe ne jemi të tillë.

Më lejoni që në emrin tuaj dhe timin ta falënderoj me këtë rast kryetarin e deritashëm të

Kuvendit të Kosovës, akademik Nexhat Dacin, për punën dhe për kontributin e dhënë në udhëheqjen e këtij tempulli të demokracisë në çastet mjaft të vështira për Kosovën dhe popullin e saj. Falënderoj partinë time – Lidhjen Demokratike të Kosovës - për besimin e dhënë.

Tash, ne duhet të vazhdojmë tutje. Lehtë nuk do ta kemi, por bashkërisht do t'ia dalim, Jam i bindur se miqtë tanë, në radhë të parë ata amerikanë dhe evropianë do të na ndihmojnë, siç na kanë ndihmuar edhe deri më sot. Amerika dhe Evropa janë këtu për të na ndihmuar që edhe ne të bëhemi pjesë e këtij civilizimi perëndimor. I garantoj këta miq se ky edhe është qëllimi ynë.

Edhe njëherë ju falënderoj për besimin e dhënë!

Faleminderit!

Biografia e Kolë Berishës

Kolë Berisha është i lindur më 26 tetor të vitit 1947 në fshatin Dobërdol të Komunës së Klinës. Shkollën fillore e kryen në Ujmirë. Pas kryerjes së shkollës së mesme (normalës) në Gjakovë, dy vjet punon mësues në Ujmirë dhe Gllarevë të Klinës, kurse nga tetë marsi i vitit 1973 punon si sekretar i gjimnazit "Luigi Gurakuqi" në Klinë. Ka të kryer edhe fakultetin Juridik në Prishtinë. Më 28 mars të vitit 1989, arrestohet dhe dërgohet në burgjet serbe në Leskoc, Beograd dhe në Pejë. Pas tre muajve, lirohet, por përjashtohet nga puna. Me themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtarësohet në të dhe për dy mandate me radhë ishte anëtar i Kryesisë së Degës së LDK-së në Klinë dhe kryetar i Komisionit për pajtimin e familjeve të hasmëruara. Nga 15 marsi i vitit 1998 është nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ishte anëtar i Këshillit Tranzitor të Kosovës së pasluftës; anëtar i Forumit politik të Kosovës të formuar nga z. Petersen. Tani është anëtar i Grupit Politik Strategjik për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Ky është mandati i tij i dytë si deputet i Kuvendit të Kosovës. Ka të botuar dy libra: "Ditari i një izolanti" dhe "Kosova plagë që pikon". Shkruan prozë dhe poezi. Në vitin 1983, në konkursin letrar të revistës letrare "Koha" të Podgoricës, i ndahet shpërblimi i dytë për tregimin "Rrëfimi i thjeshtë". Herë pas herë paraqitet me shkrime nga aktualiteti politik. Është i martuar dhe ka dy fëmijë.

Presidenti Fatmir Sejdiu flet për BBC-në

Në një intervistë për programin BBC Sot, presidenti i Kosovës flet për sfidat e tij në detyrën e re, për të ardhmen e vendit të tij si dhe sa ka ndryshuar ai vetë që prej emërimit.

Korrespondenti i BBC-së Muharrem Nitaj bisedoi në Prishtinë me zotin Fatmir Sejdiu

BBC: Zgjedhja e presidentit, shpejtësia dhe pajtimi i të gjithëve ishte një rezultat i pjekurisë politike të strukturave, të subjekteve në Kosovë, apo ndoshta kishte këtu një rol edhe një lloj presioni të faktorëve nga jashtë?

Sejdiu: Unë mendoj se është e para themelore, pra pikërisht që të shkohet në konsolidim të institucioneve dhe që reflekton thjesht me një esencë të thellë të themi kulturën politike që kanë institucionet e Kosovës dhe ne këtë rast edhe partitë politike dhe mos harroni se sprova të tilla të mira kemi kapërcyer edhe në faza të mëhershme.

Unë shpesh përmend katër cikle të zgjedhjeve në Kosovë që janë vlerësuar si zgjedhjet më të mira të Europës Juglindore dhe kjo reflekton pikërisht se njerëzit janë shumë koshientë për fazën, në të cilën ndodhemi dhe po ashtu janë të brumosur shumë thellë me elementët e një demokracie të mirëfilltë.

Çështja e dytë është se është nevoja jonë që të kemi edhe një bashkëpunim ndërkombëtar dhe ne këtë aspekt për ne është shumë e nevojshme kjo mbështetje ndërkombëtare dhe në fazat që vijnë.

BBC: Cilat kanë qenë sfidat me të cilat është përballur presidenti i Kosovës në muajin e parë të punës së tij?

Sejdiu: Janë të shumta. Mendoj se pikërisht faza në të cilën ndodhemi, ku ne pretendojmë

me të drejtë të përbyllim gjithë procesin e pavarësimit të Kosovës.

Mendoj se kjo ka qenë përballja e parë dhe çështja e dytë e rëndësishme në këtë proces që mendoj se jam përballur është pikërisht sesi të krijohet një kohezion i fuqishëm i institucioneve të Kosovës, pra të nivelit të parlamentit, të nivelit të qeverisë dhe po ashtu mendoj dhe të një rrafshi tjetër të bashkëpunimit në nivelet lokale, posaçërisht për përmbushjen e standartave dhe po ashtu dhe të pjesës së obligimeve që kanë të bëjnë me shprehjen e dinjitetit tonë në rolin e ushtruesit të drejtë-përdrejtë të funksioneve shtetërore.

BBC: President Sejdiu, meqenëse përmendët ndryshimet në qeverinë e Kosovës, sa sipas jush ato do të reflektohen në gjithë procesin e Kosovës? Sa ishin të domosdoshme që të realizoheshin në këtë moment?

Sejdiu: Sigurisht që koha do të sjellë edhe sprova të reja, posaçërisht unë çmoj atë që kryeministri i Kosovës e ka paraparë që të bëhet një rivlerësim i brendshëm i punës së gjithë stafit që ai i ka dhënë besimin dhe që mori votën e parlamentit për të parë që brenda njëqind ditësh të shohë pozicionin e secilit, qoftë i ngarkuari me detyrë apo ministrat e Kosovës dhe për të rishikuar mundësitë e ecjeve të mëtejshme, nëse ka nevojë për



Presidenti Fatmir Sejdiu

ndryshime

BBC: President Sejdiu, e keni trashëguar postin nga një njeri, i cili është vlerësuar të ketë qenë ndoshta njeri prej njerëzve më të suksesshëm të Kosovës së re, i kombit të Kosovës. Sa është e vështirë për ju që ta ushtroni këtë post, do të thosha nën hijen e një presidenti të madh, të një njeriu me vlerësimet më të mëdha që janë bërë për të ndonjëherë?

Sejdiu: Po unë plotësisht pajtohem me vlerësimet që jepni dhe janë vlerësimet tona të përbashkëta se ka qenë një personalitet unik, me gjithë strukturën e tij ta quajmë dhe gjithë përmbajtjen që ka patur. Ne kemi shansin e mirë që të shfrytëzojmë atë trashëgimi të krijuar të themi dhe të lënë nga Rugova.

Gjatë gjithë kësaj periudhe të veprimit mund të them se ka qenë privilegj për mua dhe për një brez, që kemi punuar së bashku prej ditëve të para dhe të mësojme shumë nga ai dhe natyrisht të jemi shtegtarë të përbashkët në shtigje të vështira që ka kapërcyer Kosova.

Për mua, natyrisht, është një përballje e përnjëhershme me të gjitha këto sfida dhe natyrisht me mosprezencën fizike të personalitetit të tij.

Unë do të përpiqem që nga ato mësimet që kam, natyrisht në punën e përbashkët që kemi rrugëtuar gjatë këtyre një dekadë e gjysmë, së bashku edhe me kolegë të tjerë, të mbaj atë kohezion dhe të bëj atë orientim energjie që e kemi mbi këto parime.

Së dyti, natyrisht që të jap maksimumin tim duke u angazhuar që atë pjesë të vlerës së arritur, qoftë në këtë punë të përbashkët, por edhe në pjesë

të tjera të studimeve të mia, ta vë në shërbim të interesave nacionale të popullit të Kosovës.

BBC: President Sejdiu keni deklaruar, me rastin e marrjes së detyrës, se ju do të vazhdoni projektin e presidentit të ndjerë Rugova për bërjen e shtetit të Kosovës. Si do të shkojë ky proces tash që është në fazën përfundimtare të tij?

Sejdiu: De fakto shteti i Kosovës ekziston. Ju i dini edhe fazat shumë të vështira që populli i Kosovës ka qenë nën okupim, ne i kemi vënë në lëvizje mekanizmat, të cilat i kanë pas lakmi edhe vendet thjesht të demokracisë së avancuar perëndimore, sesi kemi arritur që të ecim në një rrugëtim kaq të vështirë dhe që të mbajmë thjesht gjallë jetën e qytetarit.

Në këtë fazë, natyrisht, ne dëshirojmë të rumbullaksojmë këtë ideal të brezave të shumtë që kanë shkuar, dhe besoj se viti 2006 do të jetë rumbullaksim i këtij procesi për të hyrë Kosova në radhën e vendeve ndërkombëtarisht të njohura.

BBBC: Tash për tash besohet se ndoshta në gjithë procesin e përcaktimit të së ardhmes politike të vendit, pjesa më problematike është pozita e pakicës serbe në Kosovë. Cila do të jetë oferta që mund të bëjnë institucionet e Kosovës, në mënyrë që edhe ata të jenë pjesë e procesit të përcaktimit të së ardhmes politike të vendit, që siç thonë ju do të jetë pavarësia.

Sejdiu: Unë ndoshta do ta shikoj ndryshe këtë çështje, nuk do të dëshiroja ta problematizoj çështjen e pakicave në Kosovë, por do të dëshiroja që thjesht që të arrijmë që

të zbatohet atë vizion tonin që kemi për pozitën e gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe në këtë koncept edhe të pjesëtarëve të pakicave.

Mbase mund të jetë një qasje nganjëherë e sforcuar që të shprehet më tepër siguria apo garancia jonë që do të kemi si shumicë e përgjegjshme në relacion me prezencën e pakicave në Kosovë.

Në këtë drejtim, mendoj se Kosova ka dhënë prova të bollshme deri në këtë fazë, se qarqet afirmative që i kemi patur për integrimin e tyre dhe aktivizimin e tyre në të gjitha proceset kanë dhënë rezultatet e veta. Ka edhe hezitime, që vijnë zakonisht nga pakica serbe, e cila në vazhdimësi bie pre edhe e përllogaritjeve të shumta që i bën politika e Beogradit ndaj tyre.

Megjithatë, mund të themi se për ne është shumë e rëndësishme që të mos i kthehemi historisë. Nuk duhet të arrijmë atë çfarë kandodhur në Kosovë, por natyrisht projekti ynë është që të lëvizim përpara, duke patur parasysh një trajtim mbi bazën e standarteve më të larta ndërkombëtare që duhet t'u bëhet pakicave për një jetë më të mirë, të të gjithë qytetarëve, një jetë integruese.

Mendoj se ndoshta, kjo është esenca e gjithë asaj që do të sillte rezultate të tjera të mëvonshme.

Nuk do të angazhohem në asnjë rast, as unë dhe as institucionet e Kosovës, që të krijojmë pozicione të cilat krijojnë jetë paralele.

BBC: Besoni që ekziston një konsensus ndërkombëtar për pavarësinë e Kosovës?

Sejdiu: Deklarimet e vazhdueshme që vijnë nga zyrtarë të lartë të vendeve veç e veç

dhe mendoj vetë debatet e zhvilluara në nivelet e larta ndërkombëtare arsyetojnë thjesht hapjen e mëtejme, apo janë të përputhshëm drejtpërdrejtë me vizionin që ne kemi se pavarësia e Kosovës është një opsion real që flitet në Këshillin e Sigurimit, se pavarësia e Kosovës është e paevitueshme sikur se u fol ditë më parë në takimin e ministrave të jashtëm të Unionit Evropian në Salzburg, apo thjesht edhe qasje të tjera që kanë ta zëmë politika të jashtme europiane.

Në këtë fazë të zhvillimit tonë, ne kemi dhënë prova të mjaftueshme se mund të jetojmë me dinjitet si një shtet i pavarur, duke pasur po ashtu një objektiv tonin, një qasje për fqinjësi të mirë dhe stabilitet të përgjithshëm në rajon.

Vullneti politik është i pakapërcyeshëm, dhe është kategori kushtetuese dhe kategori ndërkombëtare, ku askush nuk mund të shkelë mbi këtë vullnet.

Ju mund të shihni edhe ecjen e popujve të tjerë, dhe pavarësimin apo emancipimin e tyre nacional. Unë mund të marrë shembuj të shumtë të deklaratave të pavarësisë që kanë edhe shtetet e fuqishme të sotme që janë krijuar.

BBC: Besoni që në mbarim të këtij viti, Fatmir Sejdiu do të jetë president i Kosovës së pavarur edhe formalisht?

Sejdiu: Po. Unë besoj se krejt si brez do ta gëzojmë një fazë të tillë dhe që them shpesh herë dhe për brezat që janë në moshë të shtyrë të mos na shkojë asnjë njeri me sy çelë në atë botë pa u zgjidh çështja e Kosovës.

Pra, praktikisht kjo dinamikë e filluar këtë vit dhe natyrisht një

orientim shumë i qartë, them edhe i zotit Ahtisari, karshi dëshirës sonë të shprehur që kjo të shkojë shumë më shpejt.

Do të jetë nëntori kur atij do t'i skadojë mandati apo kontrata e tij e lidhur me Kombet e Bashkuara. Kjo nënkupton thjesht një qasje që të shpejtohet me këtë rrugë.

Detyra jonë është që të kontribuojmë në proces, të jemi palë e të shprehim denjësinë e mekanizmit shtetëror që do të jetë i çmuar në këtë drejtim.

Ju i dini ato deklaratimet që janë bërë edhe në Këshillin e Sigurimit që ky proces duhet të shkojë i gjatë, duhet të shkojë në njëzet vjet të tjera për të arritur ndonjë emancipim të plotë nacional apo në shtetësinë formale juridikisht të njohur nga vendet e tjera, apo ndërkombëtarisht të njohur të Kosovës.

BBC: Ju zakonisht gjatë gjithë këtyre viteve u janë drejtuar me profesor Sejdiu, tash ju drejtohen me president Sejdiu. Cila prej këtyre do t'u pëlqente më shumë zoti Sejdiu?

Sejdiu: Unë mbetem shoq, mbetem profesor, dhe ajo është cilësi që e kam arritur thjesht me punën time në nivelet e arsimimit dhe të punës edukativo-arsimore dhe shkencore në Universitet.

Nuk është titull, apo nuk është thirrje që unë e hezitohet. Natyrisht, e kam jashtëzakonisht të këndshme të ndeshem me të gjithmonë dhe ai rol i imi mbetet, pozicioni aktual është një pozicion institucional themi dhe një përgjegjësi që më ka dhënë Kuvendi i Kosovës dhe subjektet politike që e kanë mbështetur.

BBC: Sa e ka vështirësuar

jetën tuaj personale, private familjare?

Sejdiu: Ka ndryshime të shumta. Ndryshimi i vetëm që nuk është në qasjen time ndaj problemeve dhe ndaj njerëzve, është që unë përpiqem sado që është vështirë të shkoj në binar normalë të asaj qasje që kam patur në fazat e mëhershme, por botën megjithatë e shikoj me atë mendje dhe me ata sy që e kam parë edhe më herët.

Për mua është shumë e rëndësishme që të jem më adapt në rrethanat e kohës dhe në përgjegjësinë që kërkohet nga unë.

Sigurisht që në pjesën e jetës private ka ndryshime të shumta, sepse dinamika e veprimeve që bëj këtu dhe rolin që duhet ta kem në këtë institucionkërkojnëshmangien apo lënien anash të një pjesë të obligimeve edhe të jetës sime familjare dhe private.

Më mungon më së tepërmi thjesht ajo që kam pasur dhe e kam preferuar gjithmonë, një rrugëtim në këmbë nga zyra ime deri në shtëpi, mbase edhe mund të ketë pasoja për shëndetin, por do të shohim në të ardhmen, do të mund t'i kthehem edhe kësaj paralel me një mirëkuptim të përbashkët.

BBC: A ka ndryshuar qasja juaj ndaj mediave dhe gazetarëve?

Sejdiu: Jo, nuk ka ndryshuar. Unë jam ai që kam qenë në fazat e mëhershme. Mendoj një komunikim normal të nevojshëm, sepse konsideroj se jeni një fuqi e rëndësishme e prezantimit edhe të vizionit tonë të përbashkët.

Do të dëshiroja që ajo pjesë e korrektësisë sonë në raporte të ndërsjella të vazhdojë.

Botuar: E shtunë, 18 mars 2006

“Nuk ka liri të plotë në Kosovë përderisa të gjithë qytetarët e Kosovës nuk e gëzojnë atë”

Fjala e kryeministrit Agim Çeku në Kuvendin e Kosovës, 10 mars, 2006

*I nderuar zoti Jesen Petersen,
I nderuar zoti Kryetar i
Kosovës,*

*I nderuar zoti Kryetar i
Kuvendit,*

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Posa mora besimin tuaj për të qeverisur vendin dhe për këtë Ju falënderoj.

Sot po ashtu po e marrë një obligim të madh për ta udhëhequr Qeverinë, për t'i përmbushur obligimet ndaj qytetarëve të Kosovës dhe për këtë jam i nderuar. Sot mora mandatin për të udhëhequr qeverinë ndoshta në kohën më të vështirë dhe më vendimtare. Dhe për këtë jam i gatshëm.

Në këto momente kyçe për Kosovën dhe për popullin e saj besimi i juaj do të jetë pikëmbështetje e punës sime në udhëheqjen e Qeverisë së Kosovës. Me marrjen e kësaj përgjegjësie, ne ju themi juve dhe qytetarëve të Kosovës se qeverisja e jonë do të jetë e bazuar në mirëqenien e qytetarit të Kosovës,

pavarësisht dallimeve etnike, fetare apo politike. Synimet tona të përbashkëta do t'i realizojmë në bashkëpunim me të gjithë ju dhe me miqtë tanë ndërkombëtarë.

Parimet e qeverisë të cilën do të drejtoj unë burojnë nga programi qeveritar. Do të përqendrohemi në forcimin e mëtejshëm të institucioneve, punësimin dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të qytetarëve të Kosovës, for-

cimin e stabilitetit politik dhe të sigurisë, përmirësimin e qeverisjes dhe kuadrin ligjor si dhe dinamizmin e punës rreth përmbushjes së standardeve me qëllim të krijimit të rrethanave sa më të volitshme për njohjen e pavarësisë së Kosovës në një kohë sa më të shpejtë.

Ndonëse gjendemi në fazën kryesore të procesit të krijimit të shtetit të Kosovës, synimet tona nuk përfundojnë me kaq. Ne kemi ende për të bërë drejt realizimit të aspiratave tona.

Ne duam një Kosovë demokratike dhe tolerante të integruar në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO. Ne duam një Kosovë që është burim i stabilitetit në region dhe katalizator i zhvillimeve pozitive në këtë pjesë të Evropës. Krijimi i shtetit të Kosovës është vullneti i popullit të Kosovës, ashtu siç është edhe i qeverisë kosovare.

Ky synim na obligon që përgjegjësitë tona ndaj këtij procesi t'i realizojmë me përpikëri. Shteti i Kosovës është objektiv madhor e i përbashkët i të gjithë neve. Por në të njëjtën kohë, mirëqenia, siguria dhe perspektiva ekonomike janë përgjegjësi të Qeverisë, që në asnjë mënyrë dhe për asnjë qëllim nuk do të anashkalohen.

Qytetari i Kosovës do të jetë në qendër të punës dhe të veprimeve tona. Ne si qeveri do të jemi të hapur ndaj të gjitha detyrimeve, duke u ballafaquar me sfidat e qeve-



Kryeministri Agim Çeku

risjes, pa e harruar se për punën tonë duhet t'i japim llogari këtij parlamenti dhe qytetarëve të Kosovës.

Ne do të krijojmë qeverisje të përgjegjshme dhe efektive që i përgjigjet nevojave të qytetarit të Kosovës. Në Qeverinë e Kosovës, nuk do të ketë vend për ata që nuk do të jenë shembuj të politikanëve të zotë, të përgjegjshëm, të përkushtuar dhe të ndershëm. Për këtë unë zotohem se do të japë gjithçka nga vetja për t'i dalë zot mandatit dhe besimit që më është dhënë sot.

Zonja dhe zotërinj,

Ne do të punojmë që të krijojmë ura të mirëbesimit në mes të njerëzve të Kosovës dhe do të arrijmë që dallimet ndëretnike t'i shndërrojmë në vlera të shoqërisë sonë. Qeveria e Kosovës do të kultivojë klimën e mirëbesimit dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë, me qëllimin më të mirë që Kosova të jetë shtëpi e të gjithë qytetarëve të saj.

Koha e urrejtjes, diskriminimit dhe vuajtjeve për qytetarët e Kosovës duhet të i takoj

së kaluarës. Ka ardhur koha e pajtimit ndëretnik e integrimeve dhe prosperitetit të gjithëmbarshëm.

Një gjë është e qartë për të gjithë. Nuk ka liri të plotë në Kosovë përderisa të gjithë qytetarët e Kosovës nuk e gëzojnë atë.

Popullata shumicë e Kosovës duhet të dijë se çelësi i realizimit të synimeve të shumicës në Kosovë është mirëqenia dhe respekti për popullatën pakicë. Andaj kujdesi ndaj pakicave është interes i shumicës. Komunitetet pakicë në Kosovë duhet të besojnë se interesat e tyre do të avancohen dhe do të mbrohen në Kosovën që ne sot po ndërtojmë andaj bashkëpunimi i ngushtë dhe konstruktiv i tyre shpejton këtë proces të rëndësishëm për ardhmërinë e Kosovës.

Komuniteti Serb i Kosovës duhet të besoj se shoqëria që po e ndërtojmë do të mbështetet në parimet më të larta njerëzore të tolerancës dhe mirëbesimit andaj e konsideroj të rëndësishme që nga ky vend të Ju drejtohem edhe në gjuhën e tyre :

“U demokratskom Kosovo i vi Srbi kao i svi drugi gradani Kosovo imate i imacete buducnost. Kosovo pripada svima i svi zajedno cemo stvoriti drus-tvu koje garantuje, slobodu, ravnopravnost i ekonomski napredak za svakoga bez obzira na nacionalnu pripadnost. U to treba da verujte. Za ovakvo drustvo, za ovakvu buducnost, treba da se iz borite zajedno sa svim drugim gradanima Kosova, sudjelujući u Vladi, u Skupstin, u Opstinama, u institucijama i u svakodnevnom zivotu Kosova.”

Për krijimin e Kosovës vend demokratik dhe prosperues

implementimi i standardeve është një nga lokomotivat e rëndësishme që shpejton këtë proces andaj dinamizmi i punës për implementimin e standardeve do të zë një vend të rëndësishëm në agjendën tonë qeverisëse.

Që nga ditët e ardhshme do të fillojmë me aktivitete të ngjeshura për implementimin e standardeve. Dhe jo pse këtë na ka vënë kusht bashkësia ndërkombëtare por për shkak se me përmbushjen e tyre i ndihmojmë vetes.

Andaj ju sigurojmë se vlerësimet nga bashkësia ndërkombëtare por edhe nga qytetarët e Kosovës do të reflektojnë angazhimet tona, veprimet tona dhe si të tilla, ato do të jenë pozitive.

Përmbushja e standardeve do të jetë argumenti jonë më i fortë në bisedimet për statusin e Kosovës. Qeveria do të luaj rol konstruktiv në procesin e bisedimeve duke e konsideruar statusin çështje të përbashkët jo vetëm të qeverisë dhe duke bërë çmos për ta ruajtur unitetin e gjithë spektrit politik në këtë proces.

Për tashprehur qëndrimin tonë rreth procesit të bisedimeve me lejoni të citoj presidentin e ndjerë amerikan JF Kenedi “ Kurrë nuk do të negociojmë nga frika, por kurrë nuk do të frikohemi të negociojmë “

Ju ftoj që të jemi të bashkuar në këtë proces, unik dhe të paluhatshëm. Nuk guxojmë të lejojmë përçarje. Nuk kemi hapësirë për gabime dhe nuk kemi kohë për t'i gabuar gabimet eventuale.

Zonja dhe zotërinj,

Shtatë vjet pas përfundimit të luftës, Kosova vazhdon të ballafaqohet me një sërë

krizash të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe në ekonominë e vendit. Papunësia është duke u shndërruar në një sëmundje kronike të shoqërisë sonë.

Furnizimi me rrymë vazhdon të jetë një problem i madh, me gjithë investimet e mëdha që janë bërë. Infrastruktura e Kosovës ende vuan nga mungesa e cilësisë, kurse arsimit dhe shëndetësia janë në një gjendje e cila kërkon shqyrtim serioz nga të gjithë ne. Duhet ta ruajmë dinjitetin e pensionistëve, mësimmësve, mjekëve, ushtarëve dhe policëve tanë.

Ne nuk premtojmë zgjidhje të të gjitha problemeve nga të cilat vuan sot Kosova. Por, në emër të Qeverisë të cilën do ta drejtoj, zotohem se do të punojmë që këto çështje të kenë vëmendjen dhe përkushtimin tonë më të madh gjatë punës sonë të përditshme.

Qeveria do të krijojë politika adekuate ekonomike dhe legjislacionin e nevojshëm që të tërheqë investimet në industri, biznes dhe në arsimimin e njerëzve sipas nevojave ekonomike të vendit. Ne duhet ta shfrytëzojmë pozitën tonë gjeografike dhe resurset tona natyrore dhe njerëzore që t'u ofrojmë investitorëve të huaj mundësi tërheqëse për investime.

Qeveria do të përkrahë dhe do të ndihmojë procesin e privatizimit, por do të punojë intensivisht që të tërheqë edhe investime të tjera në ekonominë e Kosovës. Ne duhet të shikojmë jashtë kornizave ekzistuese dhe të krijojmë një vizion të ri për një ekonomi të qëndrueshme dhe të krijojmë perspektivë për të rinjtë dhe për fëmijët tanë.

Zonja dhe zotërinj,

Me lejoni që më disa fjalë t'ju drejtohem edhe komunitetit ndërkombëtar në gjuhën angleze.

We are very grateful to the United States of America, NATO, the European Union, United Nations and all of our friends who have helped us during our difficult times. We aim to continue building our political and economic capacities as well as to work on building a secure environment for all in order to self-govern our country so that our citizens and international friends take pride on.

From here, from the Kosova Parliamentary Assembly, we emphasize our duty to continue the cooperation with Mr. Ahtisari, Special Envoy for the final status, and the members of the Contact Group to resolve the status of Kosova. We strongly believe that the state of Kosova, which will be created at the end of this process, will be a democratic state that will be the beloved homeland for all of its citizens.

Zonja dhe zotërinj,

Pavarësisht se edhe pas statusit do të ketë prezencë të NATO-s në Kosovë, gjë që para se gjithash është vullnet i qytetarëve të Kosovës, ne do të punojmë me përkushtim për të ndërtuar sistemin tonë të sigurisë, përfshirë edhe forcën mbrojtëse të Kosovës. Këtë do ta bëjmë në partneritet të plotë me NATO-n dhe miqtë ndërkombëtarë.

Kosova do të zhvillojë politika të mbrojtjes dhe sigurisë që në thelb do të ketë sigurinë e qytetarit të Kosovës dhe krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë. Kosova nga një vend konsumues i sigurisë duhet të shndërrohet një vend që prodhon dhe reflekton

siguri. Koncepti ynë i sigurisë do të bazohet në bashkëpunim me NATO-n dhe fqinjët. Ne do të përpiqemi për ta bërë Kosovën kontribuuesin më të madh të paqes dhe sigurisë në rajon.

Një kujdes të veçantë do të tregojmë për ruajtjen dhe avancimin e vlerave të mëdha të luftës. Unë për asnjë çast nuk do të harroj se prej nga vij sepse ai që nuk e din se prej nga vjen nuk e din se ku do të arrijë. Unë jam krenar që kam qenë luftëtar i UÇK-së dhe ushtar i komandantit legjendar Adem Jashari. Çdo ditë të punës sime si kryeministër do ta filloj duke pasur në mendje këto vlera të shenjta për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Përkujdesja për kategoritë e dala nga lufta: familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës do të jenë në fokus të angazhimit tim. Ne u jemi shumë borxhli këtyre kategorive, të cilat meritojnë kujdes më të madh nga të gjithë. Sa më shumë që po afrohet statusi i Kosovës aq më i madh bëhet borxhi ndaj tyre.

Shumë shpejt Kosovës do t'i jepet mundësia e pjesëmarrjes në ngjarje kulturore dhe sportive ndërkombëtare. Andaj ne një kujdes të veçantë do t'i kushtojmë kulturës dhe sportit. Gjithashtu edhe diaspora do të zë vend të merituar në programin e Qeverisë sonë.

I nderuar zoti Kryetar i Kosovës,

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

I nderuar përfaqësues special i sekretarit të përgjithshëm, Të nderuar deputetë,

Unë sot ju premtoj edhe një herë se nuk do të kursehemi në punën tonë. Në të njëjtën kohë,

mbështetja e të gjithë juve për qeverinë e Kosovës do të jetë një garanci shtesë se popullin dhe vendin tonë e presin ditë shumë më të mira. Unë e kërkoj pra këtë mbështetje nga të gjithë ju duke ju premtuar se mbështetja e juaj do të shpërblehet me suksese reale dhe shumë të prekshme të vendit tonë, Kosovës.

Ju ftoj që në frymën demokratike të vazhdoni të jeni kritike ndaj Qeverisë.

Të theksoni dhe argumentoni çdo parregullsi eventuale në qeverisje. Me këtë do t'i përmbushni edhe obligimet ndaj qytetarëve dhe do të ndihmoni qeverinë që të punojë më mirë.

Dua të theksoj në fund se me qeverinë që do të kryesoj unë nuk fillon asgjë nga e para. Ne do ta vazhdojmë kontinuitetin e qeverive para nesh dhe çdo të përpiqemi më të gjitha forcat për ta dinamizuar dhe bërë sa me efikase këtë qeveri. Dëshiroj të falënderoj me këtë rast të gjithë kryeministrat para meje z. Bajram Rexhepi, z. Ramush Haradinaj dhe z. Bajram Kosumi por edhe presidentin e ndjerë Rugovë, të cilët kanë krijuar një bazë të mirë qeverisje, mbi të cilën mund të mbështetem gjatë punës sime.

Ne jemi brezi më me fat në historinë e Kosovës. Ne na zgjodhi historia për ta sjellë lirinë në Kosovë bashkë me miqtë tanë. Këtu nuk ka asgjë të falur çdo gjë është arritur me sakrificën e shumë brezave. Jemi para fitores përfundimtare. Pas sakrificave nuk ka asgjë më të kotë se sa ngarendjen për të përvetësuar fitore. Fitorja është e Kosovës, e popullit dhe e qytetarëve të saj.

Faleminderit !

Liderët serbë të Kosovës takohen me Kryeministrin Çeku, për të diskutuar për kthimin e tyre në Qeveri

Në listën e ministrave dhe zëvendësministrave, që i është paraqitur Kuvendit të Kosovës për miratim nga Kryeministri Çeku nuk figuronin emrat e caktuar nga Lista Serbe për Kosovë dhe Metohi (LSKM). Kështu që, gjatë takimit konsultativ që pati Çeku me liderin e LSKM-së, Oliver Ivanoviqin nuk u arrit ndonjë marrëveshje konkrete për kthimin e serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës. Ndërsa, një ditë para votimit dhe mbështetjes së Qeverisë Çeku nga ana e Kuvendit të Kosovës, Çeku vuri në dukje se në bisedimet me Ivanoviqin nuk u arrit ndonjë marrëveshje. "Ne duhet të bisedojmë vazhdimisht dhe dyert për LSKM-në janë të hapura, ndaj shpresoj se ky entitet do t'i bashkohet ekipit tonë", vuri në dukje Çeku.

Ndërkaq, Ivanoviqi nga ana e tij e përjashtoi mundësinë që serbët të kthehen në institucionet e Kosovës në një të ardhme të afërt, ndonëse ai theksoi se kthimi i tyre është

tejet i rëndësishëm. "Unë nuk mendoj se ne nuk mund të kthehemi në institucione që nesër, ngase ky është një afat shumë i shkurtër për të marrë një vendim dhe një hap kaq të rëndësishëm", sqaroi Ivanoviq. Sipas tij, s'ka pikë dyshimi se LSKM-ja duhet të jetë pjesë e institucioneve të Kosovës. Ngase, shtoi ai, pjesëmarrja në institucione është e vetmja mundësi për t'i mbrojtur interesat e komunitetit serb në Kosovë. Ndërsa, Çeku premtoi se çështja e minoriteteve do të jenë prioritet për Qeverinë e tij.

Nga ana tjetër, Ministri për kthim dhe komunitete dhe njëherësh edhe i vetmi përfaqësues i komunitetit serb në qeverinë e Kosovës, Sllavisha Petkoviç, bëri të ditur se ai nuk do të refuzojë të jetë pjesë e kabinetit të ri. Kuvendi i Kosovës, ku përfshihen edhe përfaqësuesit e partisë së Petkoviçit, përkrahu qeverinë Çeku me 10 mars 2006.



Zhvillimet e fundit në Kuvend

Franklin De Vrieze, *Misioni i OSBE-së në Kosovë*

Kuvendi zgjedh Kryetarin e ri të Kosovës

Më 10 shkurt të vitit 2006, Kuvendi i Kosovës zgjodhi kryetarin e ri, z. Fatmir Sejdiu (LDK), pas vdekjes së kryetarit të mëparshëm të Kosovës, z. Ibrahim Rugova, më 21 janar 2006. E gjithë procedura e votimit është kryer në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese. Në raundin e tretë për z. Sejdiu votuan 80 deputetë (nga gjithsej 120 deputetë të Kuvendit). Në fjalimin e inaugurues, Presidenti Sejdiu theksoi se angazhimi i tij kryesor do të jetë rreth udhëheqjes së punës së ekipit negociator të Kosovës dhe se bashkëpunimi i ngushtë me ndërmjetësuesin e KB-ve për statusin e Kosovës, Maarti Ahtissarin, do të jetë i një rëndësie të veçantë. Presidenti Sejdiu i bëri nderim Presidentit Rugova, duke e çmuar lartë punën e tij si President për avancimin e unitetit politik dhe ndëretnik.

Kuvendi debaton për Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi

Më 14 shkurt 2006 Kuvendi zhvilloi një debat të nxehtë lidhur me Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi, si përgjigje ndaj kërkesës së grupit parlamentar ORA, të dorëzuar më 7 nëntor 2005. Me këtë rast, deputeti Gazmend Muhaxheri, anëtar i ORA-ës shprehu dyshimin e tij rreth vendimit për ndërtimin e Qendrës, që kap vlerën prej disa miliona eurosh, pa autorizimin e udhëheqësisë së Kuvendit. Ndërkaq, Sekretari i Kuvendit, Isuf Demaj, mbrojti vendimin dhe vlerësoi veprimet e ORA-së si përpjekje politikisht të motivuara kundër Kryetarit të Kuvendit z.Daci. Veç kësaj, krerët e grupit parlamentar të ORA-së dhe PDK-së kërkuan krijimin e një komisioni 'ad-hoc', që do t'i kryente hetimet për keqpërdorim të mundshëm të fondeve të Kuvendit. Pas debatit disa orësh, Kuvendi vendosi ta kthejë çështjen për shqyrtim të mëtutjeshëm në Kryesi.

Kuvendi i ndan fondet publike partive politike

Më 9 shkurt 2006 Kryesia e Kuvendit miratoi fondin për mbështetje demokratike, i cili ishte i njëjtë si vitin e shkuar. Fondi ka për qëllim të siguroj fonde publike për të gjitha partitë parlamentare, duke siguruar mbështetje financiare nga burimet jo private. Kryesia e Kuvendit hodhi poshtë formulën e propozuar më 6 shkurt, nga kryesuesi i Komisionit për buxhet Naser Osmani, sipas së cilës partitë më të mëdha do të përfitonin më shumë nga financimi publik. Lidhur me këtë Kryetari i Kuvendit të Kosovës ka kërkuar ndihmë nga OSBE-ja për të vlerësuar propozimin e z. Osmanit. Ndërkaq, OSBE-ja ka vlerësuar se propozimi i ri është diskriminues dhe së këndejmi nuk është në përputhje me kornizën ekzistuese legale dhe standartet për Kosovën.

Ministrja Tërmkollli refuzon të përgjigjet interpelancës

Më 25 tetor 2005, PDK-ja ka paraqitur një mocion duke e ftuar Ministren e Shërbimeve publike Melihate Tërmkollin (LDK) që të përgjigjet ndaj akuzave për shkeljen e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike, Ligjit mbi prokurimin publik, dhe Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërkaq, me 28 dhjetor 2005, ministrja i ka dërguar Kryesisë përgjigjen në interpelancë, duke pohuar se pyetja është shumë e përgjithësuar dhe se nuk ka bazë për shqyrtimin e saj, ndaj dhe "duhet refuzuar". Ndonëse, përgjigja e Ministres Tërmkollli ishte përfshirë në agjendën e seancës plenare të 14-15 shkurtit dhe edhe pse ministrja ishte edhe vetë prezente në mbledhje kur u diskutua kjo çështje, megjithatë nuk u zhvillua kurrfarë debati. Mirëpo, përfaqësuesit e opozitës protestuan, ngase sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, ministrit të cilit i adresohet interpelanca është i obliguar që ta adresojë çështjen në qeveri, si dhe për arsye se sipas rregullave deputetët e Kuvendit kanë të drejtë të debatojnë rreth çështjes së ngritur.



Kuvendi miraton legjislacion të ri

Gjatë seancës së 23 shkurtit 2006, Kuvendi miratoi, pas shqyrtimit të dytë, Projektligjin për arsimin dhe aftësimin profesional, Projektligjin për themelimin e Institutit gjyqësor të Kosovës, Projektligjin për kujdesin shëndetësor emergjent, Projektligjin për markat tregtare, Projektligjin për të drejtat e pjesëtarëve të luftës së UÇK-ës, familjeve të dëshmorëve dhe viktimave civile të luftës. Pos këtyre, Kuvendi miratoi pas shqyrtimit të parë Projektligjin për publikimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore dhe dokumenteve pedagogjike dhe Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Kryeministri Kosumi jep dorëheqje, LDK-ja kërkon dorëheqjen e Kryetarit të Kuvendit

Më 1 mars 2006, Kryeministri Bajram Kosumi dha dorëheqje. Mediat raportuan se z. Kosumi kishte humbur besimin e partisë së tij, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK-së), ngase nga njëra anë ai nuk ia doli mbanë që t'i jetësojë standartet ndërkombëtare për Kosovën (me 25 janar 2006 SP i KB-ve Kofi Annan kishte dorëzuar një raport mjaft kritik në Këshillin e Sigurimit të KB-ve rreth zbatimit të standardeve) dhe nga ana tjetër si thuhej nuk kishte qenë lojal ndaj partisë së tij. Të njëjtën ditë, Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-

së), kërkoi nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës Nexhat Daci që të japë dorëheqje. Dhe njëherësh, po në këtë mbledhje, Kryesia e LDK-së propozoi që nënkryetari i kësaj partie, z. Kolë Berisha ta zëvendësojë atë në këtë post. Me këtë rast, Kryesia e LDK-së vlerësoi se pos akuzave për keqmenaxhim dhe keqpërdorim të fondeve publike, një arsye tjetër tejet e rëndësishme për këtë vendim ishte po ashtu që të sigurohej një funksionim i mirëfillët i Kuvendit gjatë procesit të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Më pas u zhvillua një debat shumë i ashpër në media, dhe pas një diskutimi mjaft të gjatë dhe intensiv në një sesion të zgjeruar të Grupit Parlamentar të LDK-së me 9 mars, Nexhat Daci dha dorëheqje nga posti i Kryetarit të Kuvendit.

Kuvendi i Kosovës zgjedh qeverinë e re

Më 10 mars 2006, pas dorëheqjes së Kryeministrit Bajram Kosumi, Kuvendi i Kosovës zgjodhi qeverinë e re. Fillimisht, me 2 mars, Kryetari i Kosovës Fatmir Sejdiu bëri të ditur se e kishte propozuar Komandantin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK-së), Gjeneral Agim Çekun për Kryeministër të Kosovës. Menjëherë pas kësaj, Gjenerali Çeku edhe zyrtarisht iu bashkua AAK-së ndërsa me 10 mars, gjatë pauzës së seancës plenare, në një ceremoni zyrtare ai ia dorëzoi detyrën e Komandantit të TMK-së pasardhësit të tij z. Sylejman Selimit. Ndërkaq, Kuvendi votoi për z. Çeku së toku me kabinetin e propozuar nga ai, në të cilin kishte shumë pak ndryshime nga kabineti i kaluar. Kështu, z. Adem Salihaj u zëvendësua, në postin e zëvendës Kryeministrit, me z. Lutfi Hazirin, i cili njëherësh mban edhe postin e Ministrit të Pushtetit Lokal. Njëherësh, z. Fatmir Rexhepi (nga LDK-ja) u zgjodh Ministër i punëve të brendshme, ndërsa z. Jonuz Salihaj Ministër i drejtësisë.

Në të njëjtën seancë plenare, Kuvendi mbështeti kandidaturën e z. Kolë Berisha për Kryetar të ri të Kuvendit, që e zëvendësoi z. Nexhat Dacin, i cili kishte mbajtur këtë post që nga themelimi i Kuvendit të Kosovës, në dhjetor të vitit 2001. Po kështu, ish anëtari i Kryesisë, z. Fatmir Sejdiu (LDK), i cili me 10 shkurt u zgjodh President i Kosovës, u zëvendësua në postin e tij në Kryesinë e Kuvendit nga z. Sabri Hamiti (LDK).

Auditori gjeneral takon Kryetarin e Kuvendit

Më 27 mars 2006, Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi mbajtjen e takimit midis auditorit gjeneral dhe Kryetarit të Kosovës. Me 7 shkurt, Zyra e auditorit të përgjithshëm (ZAP), i pati dërguar një letër Kuvendit për ta informuar se do të ushtronte një kontroll të jashtme financiare lidhur me menaxhimin e financave në legjislativ në kuadër të auditimit të rregullt të BKK-së. Fillimi i auditimit ishte vonuar për shkak të ndryshimeve në udhëheqësinë e Kuvendit, mirëpo PSSP-ja dhe shefi i Misionit të OSBE-së e diskutuan çështjen e auditimit me Kryetarin e Kuvendit menjëherë pas zgjedhjes së tij. Me këtë rast, Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha nuk shprehu ndonjë rezervë sa i takon kontrollit financiar, duke pohuar se kjo është në interesin e promovimit të transparencës financiare dhe madje premtoi se ZAP-ja do të ketë qasje në të gjitha dokumentet.

Zëvendës Kryeministri Haziri i raporton Kuvendit lidhur me bisedat e Vjenës

Më 24 mars 2006, me kërkesë zyrtare të Kryesisë së Kuvendit, zëvendës Kryeministri dhe njëherësh Ministri i pushtetit lokal z. Lutfi Haziri, në një seancë të jashtëzakonshme, raportoi mbi negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës të mbajtura në Vjenë me 20-21 shkurt dhe 17 mars. Në fjalën e tij hyrëse, z. Haziri vuri në dukje se Kosova është e përkushtuar për zbatimin e procesit të decentralizimit, i cili do të sillte procesin e vendimmarrjes në duart e qytetarëve. Njëherësh, ai ritheksoi se për të qenë bisedimet e suksesshme, është e domosdoshme shpërbërja e strukturave paralele, ngase ato e rrezikojnë integritetin territorial të Kosovës. Veç kësaj, Haziri bëri të ditur se delegacioni i Kosovës nuk do të nënshkruajë kurrfarë marrëveshje "speciale" për decentralizimin derisa nuk gjendet një zgjidhje përfundimtare për pavarësinë. Ndërsa, lidhur me mundësinë e financimit nga Beogradi të komunave të dominuara nga serbët, z. Haziri tha se "Kosova është e hapur jo vetëm ndaj donatorëve ndërkombëtarë por edhe atyre nga vendet fqinje, përfshirë këtu edhe Serbinë. Mirëpo, të gjitha donacionet duhet të kalojnë përmes kanaleve të sistemit qendror financiar, të jenë të hapura, transparente dhe t'i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të auditimit."

Pas prezantimit të tij, u hap debati i cili bëri të mundur që 25 deputetë nga të gjitha grupet t'i shfaqin pikëpamjet e tyre. Vërejtjet dhe kritikët kishin të bënin me mënyrën se si duhej të zhvilloheshin negociatat. Ndërsa, përfaqësuesit e minoriteteve jo-serbe e shfrytëzuan këtë rast për t'i shfaqur shqetësimet e tyre për nivelin e ulët të konsultimeve me Ekipin Negociator, gjë që ua bën të pamundur atyre që ta japin kontributin e tyre për negociatën. Z. Sabri Hamiti, anëtar i grupit parlamentar të LDK-së dhe njëherësh anëtar i Kryesisë së Kuvendit, e cilësoi fjalimin e z. Haziri si "politik dhe jo përmbajtësor", ndërsa shefi i grupit parlamentar të PDK-së Jakup Krasniqi raportin e quajti "të shtrembëruar". Nga ana tjetër, AAK-ja e mbështeti punën e delegacionit të Kosovës, duke theksuar se komunitetit serb duhet t'i ofrohen "të drejta të veçanta" në fusha "të veçanta" siç janë arsimiti, kultura dhe shëndetësia. Ndërkaq, një deputet nga ORA insistoi që reforma e pushtetit lokal të jetë e njëjtë nëpër gjithë territorin e Kosovës.



Të mësohemi ta dëgjojmë zërin e qytetarit

Gjylnaze Sylja, shefe e Grupit Parlamentar të AAK-së

Jetojmë në një kohë kur demokracia është duke u përhapur në botë. Për Kosovën kjo kohë është e veçantë, sepse është kohë e ndërtimit të shtetit demokratik, me institucione dhe qeverisje demokratike. Ne i kemi themeluar me sukses strukturat demokratike të qeverisjes.

Por, tani jemi në një proces të ri të zhvillimit të demokracisë, lulëzimi i së cilës kërkon fuqizimin e mëtejshëm të institucioneve të Kosovës, përfshirë Kuvendin e Kosovës.

A është i mjaftueshëm vetëm fuqizimi i institucioneve të shtetit të Kosovës pa fuqizimin e shtetasve të saj? Një shtet demokratik mbështetet në parimin se qeveria është në shërbim të popullit; populli nuk është për t'i shërbyer qeverisë. Ose, thënë ndryshe, njerëzit janë shtetas të shtetit demokratik, por jo subjekt të tij. Andaj, fuqizimi i mëtejshëm i Kuvendit në kryerjen e detyrave të tij në mënyrë sa më efektive është domosdoshmëri e së sotmes, por edhe e sfidave të së ardhmes.

Dhe, fuqizimi i Kuvendit bëhet përmes rritjes së potencialit të anëtarëve të tij - deputetëve.

Nuk ka punë më komplekse, më sfiduese, por edhe më shpërbluese se puna e deputetit. Megjithatë, si mund të bëhesh deputet i suksesshëm? Derisa mjeku e mëson mjekësinë në shkollën e mjekësisë, juristi në atë juridik dhe pianisti në atë të muzikës, deputetët as që kanë përshkrim të kursit të studimeve se si të bëhen deputetë.

Nga kush të mësojmë ne? Mendoj se duhet të fillojmë

të mësojmë nga qytetarët. Si përfaqësues të zgjedhur duhet të mësojmë të dëgjojmë se çfarë thonë qytetarët dhe të pranojmë se qytetarët luajnë rol të rëndësishëm në proceset dhe zhvillimet në Kosovë.

Nëse duam të jemi shoqëri ku femrat dhe meshkujt kanë zërin e vërtetë për çështjet publike dhe kanë potencialin për të përmirësuar jetërat e tyre, atëherë si deputetë duhet t'i ndihmojmë qytetarët në realizimin e potencialeve të tyre.

Për më tepër, nëse zëri i qytetarëve, të cilët ndikohen drejtpërsëdrejti nga politikat e qeverisë, nuk dëgjohej në procesin e politikëbërjes, këto politika nuk do të jenë aq të suksesshme. Në fund të fundit qytetarët lidhen me qeverinë përmes shërbimeve të deputetëve në zyrat lokale.

Kështu, demokracia merr karakterin e vet pragmatik. Dhe deputeti ushtron funksionin e vet të përfaqësimit. Qytetarët duhet të kenë ndjenjën se trajtohen në mënyrë të drejtë nga ata që i kanë zgjedhur dhe se të zgjedhurit kujdesen për nevojat e tyre. Secili qytetar duhet të ketë rastin për të shprehur brengat dhe problemet e tij. Hapja e zyrës lokale për marrëdhënie me elektoratin e siguron këtë të drejtë dhe komunikimin me qytetarët.

Pse të hapet një zyrë e tillë? Për t'iu ofruar shërbime zgjedhësve. Zyra lokale duhet të jetë Kuvendi në miniaturë në zonën përkatëse.

Duke i dëgjuar mendimet e njerëzve dhe duke i lidhur këto brenga me ato të Kuvendit,



Gjylnaze Sylja

marrim përsipër rolin e urës lidhëse për zhvillimin e politikave të bazuara në nevojat e vërteta të njerëzve. Duke u kyçur në problemet lokale dhe duke iu ndihmuar qytetarëve, dëshmojmë se demokracia parlamentare ka zbatime praktike në jetët e tyre.

Përse kjo punë është e vlefshme? Përmes zyrës forcohen marrëdhëniet në mes të deputetëve dhe qytetarëve dhe rritet mundësia e deputetit që të veprojë në emër të tyre. Marrëdhëniet efektive në mes të deputetëve dhe zgjedhësve i kontribuojnë demokracisë duke forcuar lidhjet e qytetarëve me qeverinë dhe duke dhënë "vlerësimin e vërtetë" se si programet e qeverisë zbatohen në praktikë.

Deputetët me lidhje të fuqishme me zgjedhësit e vet,

kanë më shumë shansa për t'u rizgjedhur dhe avansuar në karrierën e vet politike. Zgjedhësit përfitojnë, sepse dëgjohej pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre në procesin e bërjes së politikave ose sepse e kanë përfaqësuesin në Kuvend, i cili avokon dhe përfaqëson interesat e tyre atëherë kur programet e qeverisë janë të pafavorshme për ta.

Andaj, deputeti duhet t'i përfaqësojë interesat e zgjedhësve. E këtë më së miri mund ta bëjë nëse e din saktë se kush janë zgjedhësit e tij, nëse bashkëvepron shpesh me ta dhe nëse e kupton se karriera e ardhshme politike e deputetit varet nga krijimi dhe ruajtja e mbështetjes së zgjedhësve.

Kjo është përvoja e shoqërive me demokraci të avansuar. Por, cila është përvoja jonë në Kosovë? Kuvendi i Kosovës

i ka resurset e limituara për të hapur zyra të deputetëve nëpër komuna. Por, kjo nuk duhet të na kufizojë në ushtrimin e përgjegjësisë së përfaqësimit. Për të hapur zyrë nuk duhen shuma të mëdha të hollave dhe as resurse të mëdha njerëzore. E nxitur nga ndjenja e përgjegjësisë për të qenë më afër qytetarëve dhe e ndihmuar nga Instituti Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare i SHBA-ve, kam marrë iniciativën e hapjes së zyrës në Pejë, zyrës për komunikim me qytetarët. Parimi, në të cilin jam bazuar, ka qenë ai gjeografik; jam nga qyteti i Pejës, i njoh qytetarët e saj dhe më njohin. Andaj, e konsideroj veten përfaqësuese të tyre.

Besoj se kjo iniciativë është element serioz në ndërtimin e sistemit tonë të qeverisjes demokratike dhe të krijimit të mundësisë që qytetarët tanë të kyçen praktikisht në proceset e qeverisjes dhe të zhvillimeve në Kosovë. Qëllimi im është të ndihmoj në rritjen e kapacitetit të qytetarëve të Pejës, ashtu që ata të aftësohen që problemet e veta t'i zgjidhin vetë.

Megjithë përvojën e re dhe të parë, mësimi i parë që kam marrë është se unë dhe kolegët e mi deputetë i kemi "shefa" qytetarët tanë dhe dihet se të punësuarit e mençur mundohen të jenë të përgjegjshëm ndaj brengave të "shefave" të tyre.

Mësimi i dytë, që e kam marrë, ka të bëjë me vetë kërkesat e qytetarëve. Ato kanë qenë të ndryshme, që nga kërkesa për ndihmë për punësim, pronësi, shkollim, ruajtje të monumenteve, çështjen e të zhdukurve, pensionet e deri te ndihma për kryerjen e shërbimeve në zyrat e qeverisë.

Kam pasur tri mundësi të përgjithshme në adresimin e kërkesave të qytetarëve:

- 1) ta adresoj rastin dhe t'ia kalojë stafit,
- 2) ta refuzoj rastin
- 3) të merrem personalisht me zgjidhjen e problemit.

Kjo e fundit ka qenë më joshëse dhe më fisnike.

Megjithatë, me gjithë dëshirën që personalisht të angazhohem, shpeshherë, nuk kam qenë në gjendje t'iu përgjigjem kërkesave të tyre. Por, kam mësuar se është shumë e rëndësishme që t'i dëgjoj me vëmendje dhe të shoh se çfarë mund të bëj. Nga kjo mora mësimin e tretë. Të jem realiste. Nuk mund t'i zgjidhi të gjitha problemet, por duhet t'i përcaktoj prioritetet. Nganjëherë duhet gjetur kompromis në mes të kërkesave të qytetarëve, mundësive të mia dhe të shërbimeve të kërkuara.

Dhe mësimi i katërt janë sfidat me cilat u ballafaqova. Shumica e qytetarëve pritin ndihmën e shpejtë dhe të drejtpërdrejtë nga unë. Sfida kryesore ishte koha e pamjaftueshme për t'u marrë me të gjitha kërkesat, kështu që veprimet duhej të ishin sa më të efektshme. Në këtë kontekst besoj se duhet ndërmarrë këto aktivitete për t'i krijuar marrëdhëniet me zgjedhësit.

E para: reformimi i sistemit zgjedhor. Për t'iu përgjigjur interesave të qytetarëve, ata duhet të kenë mundësinë e zgjedhjes së përfaqësuesit. Kjo nënkupton që sistemi zgjedhor në Kosovë të jetë me lista të hapura dhe me zona zgjedhore.

E dyta: Qytetarët duhet të ndjenjë se janë pronarë të

Kuvendit dhe të aktiviteteteve të tij. Andaj, zyrat për komunikim me ta duhet të jenë të hapura, në vendet ku qytetarët mund të qasen lehtë dhe të sigurohet privaciteti i tyre. Po ashtu, stafi duhet të jetë profesional dhe që di të bashkëndjëjë.

E treta: Sistemi reciprok i komunikimit në mes të deputetit dhe të qytetarëve duhet të bëhet rutinë. Ky komunikim është esencial për të forcuar mirënjohjen e publikut për punët e ndërmarrura nga deputeti, e që është mjet që siguron legjitimitetin e tij.

Edhe pse nisma për hapjen e një zyreje lokale për komunikim me qytetarët është me rëndësi, ajo nuk mjafton. Për rritjen e potencialit të deputetëve dhe

ushtrimin efikas të detyrave të tyre e, me këtë, rrjedhimisht, të rritjes së kapacitetve të Kuvendit dhe fuqizimit në kryerjen e funksioneve të tij, duhet të hapen zyrat për të gjithë deputetët.

Marrja e këtyre vendimeve dhe suksesi i këtyre veprimeve varet nga vetë ne dhe askush tjetër.

Nuk është e miftueshme të fokusohemi në kryerjen e përgjegjësisë së ligjëbërjes dhe mbikëqyrjes. Duhet të përmbushin rolin e përfaqësuesit, duke vepruar me qytetarët si partnerë të vërtetë në të gjitha ato që bëjmë. Kjo arrihet duke marrë informata, duke krijuar mekanizimin për komunikim dhe duke mësuar nga ata.

Kryesuesi i OSBE-së takohet me kryesinë e Kuvendit

Më 16 shkurt 2006 Kryesuesi i radhës së OSBE-së, Ministri i jashtëm belg Karel De Gucht, vizitoi Kosovën. Me këtë rast, ai u takua me kryetarin Fatmir Sejdiu, zëvendës shefin e PSSP-së Larry Rossin, Kryesinë e Kuvendit të Kosovës dhe delegacionin e përfaqësueseve të serbëve të Kosovës. Kryesuesi i radhës po ashtu vizitoi edhe vendbanimin e të kthyerve në Svinjarë, dhe njëherësh vizitoi edhe kontingjentin e KFOR-it belg në Mitrovicë. Gjatë vizitës së tij, z. De Gucht vuri në dukje nevojën për ecjen përpara në zbatimin e standardeve gjatë procesit të statusit, dhe njëherësh bëri të ditur se Misioni i OSBE-së është i gatshëm të japë ndihmën dhe kontributin e vet në këtë proces. Me këtë rast, De Gucht po ashtu tha se Misioni i OSBE-së në Kosovë do të jetë prezent në Kosovë edhe pas zgjidhjes së statusit.



Kryesia e Kuvendit të Kosovës



Kolë Berisha, Kryetar




Sabri Hamiti



Ramë Buja



Xhavit Haliti




Naim Maloku



Gazmend Muhaxheri



Mahir Yağçılar



Serbët e Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Kryetar Naser Osmani	Grupi Grupi i LDK-së
Zëvendëskryetare e parë Snežana Milić	Grupi SLKM
Zëvendëskryetare e dytë Safete Hadërgjonaj	Grupi i PDK-së
Anëtarët Ali Sadriu Besa Gaxherri Lutfi Zharku Naxhije Doçi Gani Koci Demir Lima Mazllom Kumnova Rifat Krasniç Nazim Jashari	Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i PDK-së Grupi i AAK-së Grupi GP 6+ Grupi ORA

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Kryetar Randel Nojkić	Grupi Grupi SLKM
Zëvendëskryetare e parë Sanije Aliaj	Grupi i LDK-së
Zëvendëskryetar i dytë Mahir Yağçılar	Grupi GP 6+
Anëtarët Nait Hasani Saša Djokić Nuran Malta Džezair Murati Numan Balić Sabit Rrahmani Xhevdet Neziraj Bislim Hoti Zulfi Merxha Rustem Ibiši	Grupi i PDK-së Grupi GP 6+ Grupi GP 6+ Grupi Për integrim Grupi Për integrim Grupi i AAK-së Grupi i AAK-së Grupi Për integrim Grupi Për integrim

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore, Peticione dhe Kërkesa Publike, dhe për të Pagjeturit

Kryetar Hydajet Hyseni	Grupi Grupi i PDK-së
Zëvendëskryetar i parë Sadudin Berisha	Grupi i LDK-së
Zëvendëskryetar i dytë Husnija Bešković	Grupi GP 6+
Anëtarët Ymer Muhaxheri Nekibe Kelmendi Ramadan B. Kelmendi Nerxhivane Dauti Hajredin Kuçi Gjylnaze Syla Dragiša Krstović Veton Surroi	Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i PDK-së Grupi i PDK-së Grupi i AAK-së Grupi i SKLM-së Grupi ORA
Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në Union Evropian	
Kryetar Sabri Hamiti	Grupi Grupi i LDK-së
Zëvendëskryetar i parë Bajram Rexhepi	Grupi i PDK-së
Zëvendëskryetar i dytë Džezair Murati	Grupi GP 6+
Anëtarët Ilmi Ahmeti Rudina Bukoshi Alush A. Gashi Nexhat Daci Jakup Krasniqi Xhavit Haliti Emrush Xhemajli Saša Djokić Teuta Sahatqija	Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i LDK-së Grupi i PDK-së Grupi i PDK-së Pa Grup Pa Grup Grupi ORA
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte	
Kryetar Enver Hoxhaj	Grupi Grupi i PDK-së
Zëvendëskryetar i parë Nimon Alimusaj	Grupi i LDK-së
Zëvendëskryetar i dytë Gojko Savić	Pa Grup

Kryetarët e Grupeve Parlamentare

Alush A. Gashi
LDKJakup Krasniqi
PDKGjylnaze Sylja
AAKRandel Nojkić
SLKMTeuta Sahatqija
ORADžezair Murati
6+Ferid Agani
Grupi për Integrim

Anëtarët			Zëvendëskryetar i parë		
Remzije Nimani			Naim Jerliu		Grupi i LDK-së
Gjylshen Berisha		Grupi i LDK-së	Zëvendëskryetar i dytë		
Ragip Zekolli		Grupi i LDK-së	Špresa Murati		Grupi GP 6+
Mark Krasniqi		Grupi i LDK-së	Anëtarët		
Drita Statovci		Grupi i LDK-së	Ilaz Pireva		Grupi i LDK-së
Sala Ahmetaj		Grupi i LDK-së	Nurishahe Hulaj		Grupi i LDK-së
Myrvete Dreshaj-Baliu		Grupi i AAK-së	Nafije Berisha		Grupi i LDK-së
Nuran Malta		Grupi GP 6+	Fehmi Vula		Grupi i LDK-së
Genc Gorani		Grupi ORA	Flora Brovina		Grupi i PDK-së
			Teuta Hadri		Grupi i PDK-së
Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion			Zahrije Jusufi		Grupi i PDK-së
Kryetar		Grupi	Zylfije Hundozi		Grupi i AAK-së
Ibush Jonuzi		Grupi i LDK-së	Zlatica Kujundžić		
Zëvendëskryetar i parë					
Bajrush Xhemaili		Grupi i PDK-së	Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media		
Zëvendëskryetar i dytë			Kryetare		Grupi
Mahir Yağçılar		Grupi GP 6+	Nekibe Kelmendi		LDK Group
Anëtarët			Zëvendëskryetar i parë		
Fadil Gashi		Grupi i LDK-së	Fehmi Mujota		Grupi i PDK-së
Brikenda Kryeziu		Grupi i LDK-së	Zëvendëskryetar i dytë		
Milazim Haliti		Grupi i LDK-së	Oliver Ivanović		SLKM Group
Zef Morina		Grupi i LDK-së	Anëtarët		
Sala Berisha-Shala		Grupi i PDK-së	Ramadan Musliu		Grupi i LDK-së
Hatixhe Hoxha		Grupi i PDK-së	Nexhat Rexha		Grupi i LDK-së
Xhevdet Neziraj		Grupi i AAK-së	Kamber Kamberi		Grupi i LDK-së
Slađan Ilić		Grupi SLKM	Januz Kastrati		Grupi i LDK-së
Teuta Sahatqija		Grupi ORA	Hajredin Hyseni		Grupi i PDK-së
			Selvije Halimi		Grupi i PDK-së
Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim			Ymer Halimi		Grupi i AAK-së
Hapësinor			Špresa Murati		Grupi GP 6+
Kryetar		Grupi	Ylber Hysa		Grupi ORA
Rifat Krasniç		Grupi GP 6+	Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë		
Zëvendëskryetar i parë			Kryetar		Grupi
Lulzim Zeneli		Grupi i LDK-së	Naim Maloku		Grupi i AAK-së
Zëvendëskryetar i dytë			Zëvendëskryetar i parë		
Goran Bogdanović		Grupi SLKM	Ylber Hysa		Grupi ORA
Anëtarët			Zëvendëskryetar i dytë		
Jusuf Sutaj		Grupi i LDK-së	Džezair Murati		Grupi GP 6+
Shaban Halimi		Grupi i LDK-së	Anëtarët		
Zyhrie Maloku		Grupi i LDK-së	Agim Krasniqi		Grupi i LDK-së
Fetah Berisha		Grupi i LDK-së	Fadil Geci		Grupi i LDK-së
Berat Luzha		Grupi i PDK-së	Samije Zeqiraj		Grupi i LDK-së
Afrim Arzuallxhiu		Grupi i PDK-së	Fadil Gashi		Grupi i LDK-së
Xhelal Canziba		Grupi i PDK-së	Qibrje Hoxha		Grupi i LDK-së
Nazim Jashari		Grupi ORA	Sokol Bashota		Grupi i PDK-së
			Emin Krasniqi		Grupi i PDK-së
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale			Xhevat Bislimi		Grupi i PDK-së
Kryetar		Grupi	Vesna Jovanović		Grupi SLKM
Fatmire Mulhaxha-Kollçaku		Grupi ORA			

Pse kërkuam dinamizimin e punës së Kuvendit

Jakup Krasniqi, Kryetar i Grupit Parlamentar, Partia Demokratike e Kosovës

GP i Partisë Demokratike të Kosovës edhe në legjislaturën e parë ka kërkuar shtimin e punës dhe seancave parlamentare në shërbim të përmbushjeve se përgjegjësi që ka marrë nga qytetarët në zgjedhjet e lira. Kërkesat i vazhduam edhe në legjislaturën e dytë, në mënyrë të veçantë nga seanca e marsit 2005, ku me forcë e argumente kërkuam formimin e një Komisioni hetimor parlamentar i cili do të hetonte disa kandidatë që gjendeshin të ripropozuar nga mandatarit, Bajram Kosumi, po atë kohë që kundërshtuar pa asnjë debat nga koalicioni në fuqi. Ne, këtë çështje e kemi përsëritur edhe në disa seanca tjera, por kryeparlamentari Daci në vazhdimësi i ka tejkaluar e injoruar për ti hapur rrugë keqeverisjes, diferencimit politik, shkeljeve të ligjeve në fuqi dhe korupcionit.

Angazhimi ynë si opozitë ka qenë që Parlamenti i Kosovës të jetë jo vetëm inicues i proceseve demokratike në Kosovë por edhe prijtar i proceseve politike për shtet të pavarur dhe sovran, për shtet ligjor ku të gjithë qytetarët janë të barabart para ligjit pa marrë parasysh dallimet etnike. Këto kërkesa i kemi përsëritur edhe në fillim të vitit 2006, ku kemi propozuar edhe çështjet që do të duheshin të vëheshin në rend të ditës, se paku në tre mujorin e parë të vitit 2006. Ne kemi kërkuar që në fillim të vitit 2006 të trajtoheshin këto çështje:

- Çështja e dokumentave të Grupit Negociator. E vendosëm këtë çështje duke qenë të bindur se Kuvendi i

Kosovës duhej të ishte në rrjedha të bisedimeve që do të zhvilloheshin për shtetin e pavarur dhe sovran, por kjo do të mund të ndodhte vetëm nëse Kuvendi punon në seanca javore e Komisione speciale, me seanca mujore, Kuvendi nuk ka mundësi as teorike ta përcjell punën profesionale e politike të ekipeve të punës së GN të Kosovës.

- Në kërkesën tonë e kemi evidencuar edhe çështjen e arsimit. Këtë e kemi bërë në rend të parë pse kemi qenë e jemi të bindur se arsimit si proces edukimi e arsimit është përcaktues në zhvillimin ekonomik e shoqëror, prandaj kërkon një përkujdesje të të gjithëve në Kosovë. Në anën tjetër, ne ishëm dhe jemi të bindur se në krye të këtij resori në kontinuitet ishin njerëz që nuk shquheshin e nuk shquhen për drejtimin, reformimin dhe përparimin e arsimit, përkundrazi e kanë politizuar skajshmërisht pa afruar zgjidhje e perspektivë për gjeneratat e reja. Shikoni gjendjen në shkolla fillore e të mesme, ne Universitetin e Prishtinës! Gjendja është edhe më e rëndë, është kaos i vërtetë dhe për këtë përgjegjësinë e ka MASHT-i.
- Vazhdojmë të kërkojmë formimin e një Komisioni hetimor parlamentar, për të hulumtuar në njësi buxhetore, duke përfshirë: Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, Presidencën dhe të gjithë segmentet që financohen nga buxheti i



Jakup Krasniqi

konsoliduar i Kosovës. Ne kemi dokumenta e të dhëna të shumta që ka shumë shkelje të ligjeve në fuqi dhe mbulim të këtyre shkeljeve që janë bërë nga MEF-i. Ne jemi të bindur se kërkesa e jonë vërfikohet edhe nga Raporti i Auditorit gjeneral dhe dëshmi të tjera që i kemi edhe ne, por që kërkohet të vërfikohet nga komisioni hetimor i parlamentit. Formimin e këtij komisioni janë duke e penguar njerëz të fuqishëm të koalicionit qeverisës.

- Ne kemi kërkuar që në tre mujorin e parë të këtij viti të debatohej edhe çështja e Drejtësisë dhe e Sigurisë, se jemi të bindur se këto dy segmente janë të përvitale janë në zhvillim në Kosovë si edhe për të ardhmen e Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Pa drejtësi e siguri nuk ka sundim të ligjit e për pasoj as shtet ligjor, nuk ka as siguri e qarkullim të lirë të njerëzve dhe mallrave. Në këto segmente duhet të

bëhet një reformë e thellë dhe e gjithanshëme.

Ne kemi kërkuar edhe disa çështje të tjera, por jemi të bindur se zhvillimet e fundit që po ndodhin në Kosovë e për Kosovën, para Kuvendit të Kosovës kanë dalë e po dalin kërkesa të tjera që kërkojnë angazhime e përgjegjësi të reja për Kuvendin dhe parlamentarët. Nëse nuk vazhdohet me seanca një javore, Kuvendi i Kosovës nuk do të arrin ta përmbush asnjë përgjegjësi të tij e as të merret më problemet më vitale që po dalin e do të dalin para Kuvendit dhe institucioneve tjera të Kosovës. Prandaj ne vazhdojmë të këmbngulim në kërkesën tonë të përsëritur që sa herë e të cilën do të vazhdojmë ta përsërisim edhe në të ardhmen.

Parlamenti ynë, Kuvendi i Kosovës i dalë nga zgjedhjet e lira duhet të filloj punën me kapacitet të plotë e përgjegjësi të shtuara. Të shpresojmë se më në fund po fillon të ndodh diçka e mirë në institucionet e Kosovës!

Vizion për Kosovën e pavarur

Dr. Ferid Agani, Kryetar i Grupit Parlamentar "Për Integrim", Partia e drejtësisë



Ferid Agani

Në Dhjetorin e vitit 2005, deputetëtegiashtëpartivepolitike të përfaqësuar në Kuvend konkluduan se proceset demokratike në institucionin më të rëndësishëm të Kosovës, përkundër përparimeve ende nuk e kanë arritur shkallën, që do të mundësonte artikullimin e mirëfilltë të qëndrimeve të tyre politike, të siguruar përndryshe me norma kushtetuese dhe me Rregulloren e Punës. Rrjedhimisht, Deputetët e Partisë së Drejtësisë, Partisë Liberale të Kosovës, Partisë Demokratike të Ashkalijve të Kosovës, Partisë për Aksion Demokratik, Iniciativës Qytetare të Gorës dhe të Partisë së Bashkuar Rome të Kosovës, themeluan grupin parlamentar "Për integrim".

Themelimi i grupit të ri politik u mirëprit nga zyrtarët e Kuvendit të Kosovës dhe u përkrah nga OSBE dhe Instituti Kombëtar Demokratik nga SHBA (NDI).

Grupi parlamentar "Për Integrim", me përbërjen e tij multietnike dhe shumëkonfesionale përfaqëson vlerat e larta qytetëruese të trashëgimisë kulturore, historike dhe politike të shoqërisë kosovare të sublimuara në gadishmërinë për bashkveprim demokratik të të gjithë qytetarëve të saj, në proceset shtetformuese për Kosovën e pavarur. Ai është dëshmi e kontinuitetit historik të bashkëjetesës paqësore dhe konstruktive të qytetarëve të Kosovës me përkatësi të ndryshme etnike, fetare, sociale, politike, ekonomike etj.

Synime të tij themelore janë, përmirësimi i funksionimit demokratik të Kuvendit të Kosovës dhe ngritja e shkallës së unitetit politik në të, në periudhën kritike të përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës.

Senzibiliteti politik dhe promovimi i frymës së sinqertë të bashkëpunimit në procesin

e ndërtimit të shtetit të përbashkët para-qesisë cilësitë esenciale të grupit tonë parlamentar. Me strukturën specifike shumënacionale kemi për qëllim që faktorëve politik, vendor dhe ndërkombëtarë, t'u dëshmojmë ekzistimin e potencialeve demokratike brenda Kuvendit të Kosovës për realizimin e veprimtarisë së përbashkët politike në baza multietnike dhe shumëkonfesionale. Jam i bindur se bashkëveprimi politik i deputetëve të partive politike që përfaqësojnë një pjesë të popullatës shumicë shqiptare dhe katër bashkësi etnike në Kosovë: romë, ashkalij, goran dhe një pjesë të komunitetit boshnjak, paraqet dëshmi më domethënëse dhe më bindëse politike se sa deklarimet e thata verbale për multietnicitetin dhe për parime demokratike.

Grupi parlamentar "Për integrim" është dëshmi konkrete se përfaqësuesit politik të komuniteteve etnike pakicë që jetojnë në Kosovë dhe përfaqësuesit politik të popullit shqiptarë nuk duhet të bashkëpunojnë vetëm duke qëndruar përballë njëri tjetrit por, në rradhë të parë, krahas njëri tjetrit sepse të gjitha angazhimet politike i kanë të drejtuara kah synimet dhe objektivat e përbashkëta. Ai paraqet dëshmi të unitetit të lartë politik kur janë në pyetje çështjet madhore për të ardhmen e Kosovës dhe provë konkrete për bashkësinë ndërkombëtare se synim parësor i institucioneve të Kosovës nuk është shteti nacional shqiptar por shteti multietnik, në të

cilin do të zotërojnë parimet demokratike të mbështetura në vlerat qytetëruese të kulturave autoktone.

Ka ardhë koha, që t'i dëshmojmë vetes dhe të tjerëve se në Kosovë ka potenciale demokratike dhe vizionare për shtet të pavarur, të suksesshëm dhe demokratik. Për pjesëtarët e grupit tonë parlamentar është e qartë se ekskluziviteti nacional nuk është rrugë në këtë drejtim.

Jam i bindur se me këtë, në asnjë mënyrë nuk do të zbehen sakrificat monumentale të popullit shqiptar të Kosovës gjatë luftës shekullore për arritjen e lirisë dhe të pavarësisë. Përkundrazi, me gadishmërinë që në baza plotësisht të barabarta të bashkëpunojë edhe në rrafshin politik me komunitetet e tjera etnike me të cilat bashkëjetojnë, populli shqiptarë do të ngritet lartë në piadestalin e kombeve liridashëse të botës, që synuan dhe arritën sovranitetin dhe pavarësinë e plotë duke respektuar parimet më demokratike dhe më qytetëruese.

Si grupi më i madhë politik multietnik në Kuvendin e Kosovës, Grupi parlamentar "Për integrim" pret përkrahje nga të gjitha grupet parlamentare si dhe partnerët relevant ndërkombëtarë në realizimin e synimeve fisnike që ia ka përcaktua vetes, në të mirën e funksionimit demokratik të Kuvendit të Kosovës dhe të mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa asnjë përjashtim.

Ku do të jenë serbët kur të përfundojnë bisedimet?

KOHA PËR SHLYERJEN E HESAPEVE

Zoran Culafic, gazetar i pavarur nga Beogradi



Politikanët lokal serbë hynë në fazën përfundimtare të bisedimeve për status, më të dobët se kurrë më parë, në këto gjashtë vitet e fundit. Të përçarë dhe pa ndonjë vizion dhe strategji, atyre nuk iu është lënë shumë hapësirë për manovrim në konkurrencën politike me shqiptarët e Kosovës dhe Bashkësinë Ndërkombëtare. Së këndejmi, e vetmja gjë, që mund të parashikohet është padyshim, eskalimi i konflikteve midis partive politike serbe brenda bllokut politik serb dhe të dy palët, si politikanët ashtu edhe shumica e serbëve në Kosovë janë të vetëdijshëm për këtë. Edhe vetë përfaqësuesit e administratës ndërkombëtare e kanë kuptuar këtë fakt, dhe së këndejmi e kanë rishikuar me kujdes strategjinë e përgjithshme politike në fazën përfundimtare të bisedimeve për statusin e Kosovës. Porosia është mjaft e qartë: afër mendsh se do të ishte shumë mirë, që serbët të merrnin pjesë në proceset demokratike

të Kosovës, mirëpo, pa marrë parasysh se a marrin pjesë apo jo, këto procese do të vazhdojnë – me apo pa serbët.

Brenda skenës politike serbe në Kosovë, tani është vështirë të identifikohen “akterët e rëndësishëm.” Ndonëse, në lojë janë të përfshirë disa gupe politike dhe individë.

Lista serbe për Kosovë dhe Metohi (LSKM), e kryesuar nga Oliver Ivanoviqi, përbën një koalicion të tri partive – Partisë Social-Demokrate (PSD), Lëvizjes për Ripërtrirjen Serbe (LRS) dhe Partisë Demokratike (PD). Fakti, që selitë e këtyre partive janë në Beograd është i një rëndësie të veçantë jo vetëm për aktivitetet politike të këtij koalicioni por edhe për veprimet e ardhshme të vetë Ivanoviqit. Së këndejmi, të gjitha analizat rreth asaj se a të do të hyjë ky koalicion apo jo në Qeverinë e Kosovës, duhet të kundrohesh nga kjo pikëpamje, ndonëse Ivanoviqi ka faktuar vazhdimisht se ai ka një shkallë të lartë të integritetit politik dhe është në gjendje

të marrë vendime të rëndësishme, pavarësisht nga diktatet e Beogradit.

Veç kësaj, përfaqësuesit diplomatikë, që vizitojnë Prishtinën nuk e lënë pa u takuar me Oliver Ivanoviqin, duke i dërguar Beogradit në këtë mënyrë porosi mjaft të qartë për dëshirën e tyre, që ta shohin atë si partner në skenën politike të Prishtinës. Emërimi i Kryeministrit të ri të

Kosovës ka qenë një mundësi ideale për LSKM-në të hyjë në Qeveri, mirëpo, meqë zgjedhja e komandantit të mëparshëm të TMK-së, Agim Çekut ishte e papranueshme për Kryeministrin e Serbisë dhe Malit të Zi, Koshunicën, kjo mundësi u humb më kot. Megjithatë, në opinion ende spekulohet se Ivanoviqi së shpejti do të marrë vendim kokë në vete, përkundër kundërshtimeve të Koshtunicës, nëse i jepet posti i Ministrit për kthim dhe komunitetet, që për momentin mbahet nga Slavisha Petkoviqi. Vlen të vihet në dukje se posti i ministrit për bujqësi, dy postet e zëvendës ministrave dhe ca poste në Bordin Drejtues janë rezervuar për Koalicionin e LSKM –së.

Në javët e fundit, Slavisha Petkoviqi, ka humbur disa poste jo vetëm në Qeveri por edhe brenda partisë së tij. Njëri prej bashkëpunëtorëve të tij, Dragisha Miriq, e ka shkëputur një krah të PDS e KM, të cilët për vete pohojnë se janë

pasardhës të vërtetë të partisë, dhe madje ata kanë kërkuar edhe ndërrimin e Petkoviqit. Madje në Prishtinë mund të dëgjohen edhe spekulime se ka të ngjarë që Petkoviqi të përballet edhe me padi penale, për shkak të dyshimeve për shpërdorimin e mjeteve financiare. Pos kësaj, ai nuk ia doli që të krijojë marrëdhënie të mira me Kryeministrin Çeku. I pakënaqur me vendimin për emërimin e kolonel Dejan Jankoviqit, si zëvendës ministër i punëve të brendshme, Petkoviqi deklaroi se e kishte ngrirë pozitën e tij si ministër, ndonëse është vështirë të kuptohet se çfarë do të thotë kjo praktikisht.

Megjithatë, duket se Petkoviqi për momentin mban të paktën një adut të fortë në dorën e tij, dhe kjo për faktin se dy nga deputetët e PDS-së për KM në Kuvendin e Kosovës i kanë mbetur besnik atij, dhe pikërisht këta deputetë, mund të sigurojnë shumicën për koalicionin qeverisës në Prishtinë.

Në këtë situatë, duket se rasti i parë për Oliver Ivanoviqin mund të jetë pasi të kalojnë njëqind ditët e para të qeverisjes së Kryeministrit Çeku, ngase Kryeministri ka bërë të ditur se deri atëherë, do të bëjë një vlerësim të punës të të gjitha ministrave, dhe se madje edhe do t'i ndërrojë ministrat nëse nuk punojnë sa duhet.

S'do mend se grupi më me ndikim në Kosovë është ende Këshilli Nacional Serb (KNS), për faktin se shumica e anëtarëve të KNS-së janë anëtarë të Partisë Demokratike

Serbe (PDS), e cila tani për tani është partia kryesore në Qeverinë e Serbisë, dhe njëherësh ka kontroll të plotë edhe mbi aktivitetet e Qendrës Koordinatave për Kosovë e Metohi. Ky grup ka më shumë ndikim në Kosovën Veriore. Ndërsa, ndryshimet e kohëve të fundit përbrenda KNS-së nuk janë përmbajtjesore, ndaj "bashkimi" i KNS-së të Kosovës veriore me KNS-në e Kosovës qendrore mund të quhet si lëvizje kozmetike. Tashmë, është më se e qartë, se Kryeministri Koshtunica në këtë mënyrë demonstroi se çfarë do të jetë pozita politike e Beogradit në Kosovë, në muajt e ardhshëm.

Megjithatë, Koshtunica së shpejti do ta ketë rastin të demonstrojë në praktikë atë, se sa kujdeset për serbët në Kosovë. Nëse e tërë veprimtaria e tij politike vazhdon të konsistojë në protesta rreth "kriminelëve të luftës" si në grupin negociator ashtu edhe brenda udhëheqësisë së Qeverisë së Kosovës, atëherë serbët e Kosovës padyshim do të fitojnë shumë më pak, krahasuar me atë çfarë shqiptarët e Kosovës dhe Bashkësi Ndërkombëtare janë të gatshëm t'u ofrojnë atyre tani.

Pavarësimi eventual i Kosovës është kërcënim për serbët, megjithatë, disa analistë pohojnë se një goditje edhe më e madhe për serbët do të mund të ishte marrja e të drejtës për të ashtuquajturën shtesë të Kosovës, d.m.th. pagat e dyfishuara për ata, të cilët janë të punësuar në shëndetësi, arsim dhe institucione të tjera të Qeverisë serbe. Ndërkaq, marrja e këtij vendimi varret drejtpërsdrejti dhe ekskluzivisht nga Koshtunica.

Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Kosovës

Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Kryetare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Partia Reformiste ORA

Në legjislaturën e dytë të Kuvendit të Kosovës, nga dy komisionet e mëparshme, është formuar një Komision Parlamentar tani me një fushëveprimtari shumë më të gjerë pasi që mbulon dy Ministri, Ministrinë për Shëndetësi dhe Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Ndonëse komisioni përbëhet nga dymbëdhjetë anëtarë nga parti të ndryshme, të gjitha vendimet deri tani janë marrë me konsensus të plotë.

Deri tani komisioni ka shqyrtuar një numër të madh ligjesh prej të cilave do të veçoja Projektligjin për Inspektorat Shëndetësor, për Mjekësi Emergjente, për Vlerat e Luftës, për Duhan, për Shërbime Sociale dhe Familjare, për Ushqim etj.

Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale ka shqyrtuar gjithashtu edhe Projektligjin për Sigurime Shëndetësore, ligj shumë i rëndësishëm për funksionimin e mirëfillt të sistemit shëndetësor, mirëpo ky projektligj nuk ka kaluar në Kuvend në lexim të dytë për shkak të deklaratës financiare jo të plotë.

Komisioni gjatë shqyrtimit të projektligjeve ka mbajtur edhe dy dëgjime publike me ekspert të fushave përkatëse, me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, me qëllim të përfshirjes së një numri sa më të madh të opinionëve të njerëzve të cilët do të jenë përfitues nga zbatimi i Ligjeve të cilat shqyrtohen.

Gjatë punës së vet komisioni bashkëpunon edhe me shumë



Fatmire Mullhaxha, në të djathtë, gjatë një vizite në spital

organizata dhe institucione si Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), Misioni i OSBE-së në Kosovë, Fondacioni Fridrich Ebert Stiftung, të cilëve u jemi mirënjohës për ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme.

Përveç procedimit të Ligjeve, pjesë shumë e rëndësishme e punës së Kuvendit është edhe mbikëqyrja e Qeverisë, në këtë rast e Komisionit si monitorues të punës së dy Ministrive të cilat i mbulon. Si shembull konkret të mbikëqyrjes do ta veçoja një iniciativë të Komisionit të përkrahur nga NDI, në monitorimin e implementimit të ligjit për Shëndetësi. Aktiviteti i parë i Komisionit në këtë drejtim ishte mbikëqyrja e Ministrisë së Shëndetësisë në nxjerrjen e akteve të duhura nënligjore - mos nxjerrja e të cilave apo vonimi i nxjerrjes së tyre në fakt e pamundëson implementimin e ligjit në pjesë të madhe të tij. Aktiviteti i dytë ishin edhe vizitat e parapara në teren ku kemi pas rastin që për së afërmi të njoftohemi

me imp-lementimin e Ligjit, pengesat që paraqiten në implementimin e tij, si dhe me faktin se sa është ligji i aplikueshëm. Deri tani Komisioni ynë ka vizituar institucionet shëndetësore të nivelit parësor, dytësor dhe tretësor në Prishtinë, Ferizaj dhe Pejë. Me këtë rast kemi pasur takime të shumta me punëtorët shëndetësor, si me stafin udhëheqës ashtu edhe me punëtorët tjerë, por edhe me vet shfrytëzuesit e shërbimeve.

Në kuadër të kësaj parashohim që ti mbajmë edhe disa dëgjime publike me ofruesit e shërbimeve shëndetësore, shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve si dhe me stafin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas përfundimit të mbledhjes së dëshmimeve është parapare përpilimin e një raporti me rekomandime të Komisionit me qëllim të thirrjes së një seance plenare ku do të debatohet lidhur me situatën në shëndetësi.

Sfidat dhe përmirësimet në punën e Kuvendit të Kosovës

Rebecca Kilhefner, Misioni i OSBE-së në Kosovë



Kuvendi i Kosovës tani është pothuajse në gjysmën e mandatit të tij të dytë. Më poshtë po e japim një vështrim të shkurtër mbi përmirësimet në funksionimin e tij dhe respektimin e procedurave, si dhe për sfidat që e presin.

Përcaktimi i agjendës

Sipas rregullores së punës së Kuvendit agjenda për secilën seancë plenare duhet të përgatitet paraprakisht nga Kryesia e Kuvendit dhe t'i prezantohet Kuvendit për miratim, para seancës së radhës. Zbatimi i këtyre përgatitjeve bën të mundur jo vetëm që deputetët e

Kuvendit t'i paraqesin vërejtjet e tyre rreth agjendës së propozuar por edhe që seancat plenare të Kuvendit ta kenë fjalën përfundimtare në përcaktimin e rrjedhës së punës së Kuvendit.

Gjer më tani, agjenda përgatitej dhe u dërgohej deputetëve vetëm disa ditë para fillimit të sesionit plenar. (Ky problem rreth përgatitjes së agjendës ishte pjesërisht edhe rezultat i asaj që Kuvendi mbante mbledhje një herë në muaj, e jo një herë në javë, për të cilën gjë do bëjmë fjalë në vijim). Vlen të vihet në dukje se agjenda zakonisht nuk është miratuar zyrtarisht nga Kuvendi, madje as në fillim të

seancës, përpos nëse një apo më tepër deputetëve u është dhënë fjala për t'i paraqitur vërejtjet e tyre që në fillim të seancës. Së këndejmi, kjo ka bërë që nganjëherë të mbahen debate të gjata, midis seancës plenare, për të vendosur se a duhet apo nuk duhet shqyrtuar atë ditë pika të caktuara të rendit të ditës. Madje një rast mjaft ekstrem, që vlen të përmendet është kur një ministër po përgatitej që të prezantonte një draft ligj për shqyrtim të parë, një deputet doli me mendimin se, sipas legjislacionit ekzistues, çështjet që trajtohen në projekt ligj duhet të rregullohen përmes legjislacionit subsidiar, e jo përmes një ligji të ri. Ky

pohim shkaktoi një debat të tejzgjatur rreth asaj se a duhet draft ligji apo nuk duhet të prezantohet, ndërsa deputetët e Kuvendit shprehën keqardhjen për situatën "e palakmueshme" që u krijua, e cila pa dyshim se do të mund të evitohet nëse agjenda do të përgatitej dhe miratohej ashtu si është parashikuar me rregullore të punës.

Mirëpo, një gjë mjaft pozitive që ndodhi disa muaj më parë krahasuar me praktikën e mëparshme ishte se Kryesia filloi t'i përgatisë agjendat paraprakisht dhe t'i paraqesë ato për miratim në Kuvend. Ishte ky një ndryshim i mirëseardhur dhe mirëpritur. Për t'u siguruar se çështjet dhe shqetësimet e grupeve parlamentare do të merren parasysh, Kryesia duhet ta bëjë praktikë që, me rastin e përgatitjes së agjendës, të konsultohet me kryesuesit e grupeve parlamentare, ashtu si është parashikuar me rregullore.

Votimi

Sipas Kornizës Kushtetuese dhe rregullave të procedurës, vendimet në Kuvend merren nëse për te votojnë shumica e deputetëve që janë prezentë në mbledhje, përpos në raste të veçanta kur parashikohet ndryshe. Kjo do të thotë se në rastet kur një numër i konsiderueshëm i deputetëve nuk voton, propozimi mund të kalojë edhe nëse për te votojnë më pak se gjysma e deputetëve, por me kusht që të ketë më shumë vota për se

kundërpropozimit. Së këtejmi, është me rëndësi që gjithnjë të kërkohet të numërohen votat kundër, edhe nëse në favor të propozimit kanë votuar një numër relativisht i vogël. Mirëpo, në të shkuarën ka rastisur mjaft dendur që kjo dispozitë të keqinterpretohet, gjë që ka shkaktuar debate të ashpra në Kuvend lidhur me atë se a ka kaluar apo nuk ka kaluar ndonjë propozim i caktuar. Dhe madje, ka pasur edhe raste kur një propozim që ka kaluar të shpallet si i dështuar dhe anasjelltas.

Korniza Kushtetuese dhe Rregullorja e Punës nuk përmbajnë dispozita të veçanta që përcaktojnë se cilat nga opsionet e mundshme të votimit mund të shfrytëzohen, gjë që ka shkaktuar konfuzion kur Kuvendi është dashur të vendosë për zgjedhjen e një numri të caktuar të njerëzve në një organ të caktuar. Ndaj dhe Kuvendi duhet t'i përcaktojë më qartë procedurat që duhen ndjekur kur votohet për çështje më të komplikuar, si fjala vjen emërimet në qeveri, agjenci të pavarura si dhe organe të tjera.

Debatet

Kohëve të fundit ka pasur një tendencë që debatet në Kuvend të jenë më të lira, më spontane dhe më gjithëpërfshirëse krahasuar me më përpara, kur deputetëve nuk u jepej fjala me arsyetimin se nuk ka mbetur kohë e mjaftueshme për diskutim apo madje edhe kur urdhërohej që disa deklarata "të hiqeshin nga raporti (procesverbali)", për shkak të përmbajtjes së tyre. S'ka pikë dyshimi se të gjithë deputetët e Kuvendit kanë

njëlloj të drejtë që të marrin pjesë si në debatet e Kuvendit ashtu edhe në ato të seancave plenare, ashtu si parashikohet në rregulloren e punës së këtij organi, ndaj mund të thuhet se tendencat dhe praktikatat aktuale janë mjaft të vonuara. Megjithatë, gjatë këtyre debateve deputetët duhet të jenë të përgjegjshëm dhe njëherësh duhet të ekzistojë edhe një lloj kontrolli nga personi i cili e kryeson sesionin.

Po kështu, sipas rregullave deputetëve u ndalohet përdorimi i "gjuhës joparlamentare" (gjuhës fyese, shpifëse, kërcënuese apo të pahijshme, sulmeve apo fyerjeve personale, apo edhe gjuhës përçmuese dhe fyese ndaj komuniteteve), ndaj dhe kryesuesi i sesionit ka për detyrë që t'ia tërheqë vërejtjen secilit deputet që përdorë gjuhë të këfillë. Ndonjëherë nuk është edhe aq e lehtë që, aty për aty, të bëhet dallimi midis deklaratave provokuese dhe gjuhës jo-parlamentare, posaçërisht nëse kryesuesi i seancës nuk dëshiron të konsiderohet se po e pengon një debat të lirë. Në disa parlamente ekziston një listë e tërë e shprehjeve apo edhe deklaratave të ndryshme, të cilat konsiderohen si gjuhë jo-parlamentare, me qëllim që të parandalohen vendimet arbitrate ndaj deklaratave të tyre. Pos kësaj, madje edhe për deklaratat që nuk janë përfshirë në këtë listë por që megjithatë mund të konsiderohen si gjuhë jo-parlamentare nganjëherë zhvillohet debat i gjerë. Së këndejmi, është e udhës që organet e Kuvendit, si fjala vjen Kryesia apo edhe

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese të hartojnë udhëzime me të qarta dhe më të detajuara rreth gjuhës jo-parlamentare.

Ndërkaq, sa i takon kohëzgjatjes së debatit parlamentar, Kryesia mbase do të duhej të përcaktojë një kufizim kohor për debate të veçanta para seancës plenare, brenda mundësive në konsultim me shefat e grupeve parlamentare. Në një marrëveshje të këfillë mund të përfshihet edhe caktimi i kohës për debat për secilin grup parlamentar, i cili duhet të jetë përafërsisht në proporcion me përfaqësimin e tyre në Kuvend, dhe me këtë rast njëherësh është e udhës që të ndahet pak kohë edhe për deputetët që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentarë, nëse dëshirojnë ta marrin fjalën. Ndërsa, pastaj grupet parlamentare i caktojë deputetët e tyre që do të flasin si dhe e ndajnë kohën në dispozicion në mes deputetëve.

Denduria e mbajtjes së mbledhjeve

Miratimi i propozimit për mbajtjen e seancave plenare një herë në muaj, para dy vitesh, ka shkaktuar një sërë problemesh procedurale dhe të tjera. Pikë së pari, si u vu në dukje që në fillim të këtij artikulli, ishte e vështirë për Kryesinë që ta përgatiste agjendën paraprakisht dhe ta paraqiste për miratim për seancën e radhës, ashtu si kërkohet me rregulloren të punës, për arsye se ishte e pasiguritë se cila pikë e rendit të ditës do ishte e gatshme

për shqyrtim pas një muaji. Përpos kësaj, me rregulloren të punës janë parashikuar afate shumë të ngushta kohore për leximin e parë të draft ligjit "jo më herët (parë) se dhjetë ditë pune dhe jo më vonë tri javë të punës që nga dita e shpërndarjes", që e bënte të vështirë për t'iu përmbajtur kur mbledhjet mbaheshin një herë në muaj. Dhe ç'është më e rëndësishmja, ndonëse kishte mjaft pika të rëndësishme të rendit të ditës ato shtyeshin me muaj. Fjala vjen, nëse ndonjë nga ministrat nuk ishte prezent për t'iu përgjigjur pyetjeve që bëheshin nga deputetët apo nëse shqyrtimi i ndonjë draft ligji për një arsye të caktuar duhej të shtyhej deri në seancën tjetër plenare, këto pika shpeshherë shtyeshin për të paktën një muaj në vend se të shtyhen vetëm për një javë. Veç kësaj, kur mbaheshin sesionet një herë në muaj, pos shqyrtimit të draft legjislacionit, nuk kishte aq shumë kohë për kryerjen e punëve të tjera, si bie fjala për pyetjet që i shtroheshin qeverisë dhe për debate mbi çështje shumë të rëndësishme. Kohëve të fundit ka pasur indikacione se Kuvendi do të fillojë të mblidhet më dendur dhe më rregullisht- dhe vërtetë, gjatë muajve shkurt dhe mars janë mbajtur më shpesh sesione plenare krahasuar me muajt e shkuar. Së këndejmi, ky trend duhet institucionalizuar, duke vazhduar me mbajtjen e sesioneve plenare një herë në javë, në mënyrë që të bëhet e mundur që Kuvendi ta japë kontributin e tij të plotë dhe të mirëfillët në këtë kohë kaq të rëndësishme nëpër të cilat po kalon Kosova.

Rrugëtimi i Kosovës drejt integritimeve evropiane

Torbjorn Solhstrom, Përfaqësues personal i Javier Solanës në Prishtinë

Ish Kryeministri i Britanisë Winston Churchill me një rast pati thënë se Ballkani është një rajon që ka prodhuar më tepër histori se sa që mund të kapërdijë (përballojë). Ndonëse mund të ketë edhe të vërteta në këtë pohim, megjithatë Kosova dhe institucionet e saja kohëve të fundit kanë provuar se janë të afta për të përballuar ndryshime të konsiderueshme brenda një kohe mjaft të shkurtër.

Me këtë rast, vlen të vihet përmendur se menjëherë pas vdekjes së parakohshme të Presidentit Ibrahim Rugova, në janar të këtij viti, zgjedhja e Fatmir Sejdiut për President të Kosovës u bë mjaft shpejtë. Veç kësaj, pas dorëheqjes së Kryeministrit të Kosovës Bajram Kosumit, me 10 mars u zgjodh qeveria e re në krye me Komandantin e Trupave Mbrotjtës të Kosovës Agim Çekun. Njëkohësisht, Kuvendi zgjodhi Kryetarin e ri Z. Kolë Berishën. Kështu që, brenda më pak se dy muajve pati ndryshime në tri pozitat më të larta të institucioneve të Kosovës. S'do mend se kjo nuk

ishte aspak e lehtë. Por, mënyra në të cilën institucionet politike i kanë tejkaluar këto sfida ka qenë shenjë e një pjekurie dhe përgjegjësie.

Këto ndryshime u bënë pikërisht në periudhën më kritike dhe vendimtare për Kosovën. Ndërsa pas emërimit të ish Presidentit finlandez Martti Ahtisaari si i Dërguar Special i KB-ve, filloi edhe procesi i bisedimeve që ka për qëllim përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Me këtë rast, ministrat e jashtëm të UE-së shprehën mbështetjen e tyre të plotë për të Dërguarin Special dhe ranë dakord për emërimin e Z. Stefan Lehne si Përfaqësues të UE-së në procesin e bisedimeve për status. Kështu që, UE-ja jo vetëm që është duke bashkëpunuar ngushtë me ekipin e Presidentit Ahtisaari por është duke marrë pjesë edhe në të gjitha aspektet e procesit të bisedimeve për status.

Afër mendsh se për shkak të pozitës gjeografike të Kosovës, në qendër të Evropës, procesi i bisedimeve për status- dhe

rezultati që do të dalë nga ky proces-është tejet i rëndësishëm për UE-në. Tok me partnerët e tjerë ndërkombëtarë në Kontakt Grup, Përfaqësuesi i Lartë i UE-së Javier Solana, në deklaratën e Londrës të 31 janarit ka përcaktuar disa nga parametrat kryesorë për punën që duhet bërë në të ardhmen. Më e rëndësishmja është se aty vihet në dukje se duhet bërë çmos për të siguruar që procesi i bisedimeve rreth statusit të përmbyllet deri në fund të vitit 2006.

Krahas bisedimeve për statusin e ardhshëm, vazhdon edhe implementimi i standardeve dhe reformave kryesore evropiane të parashikuara me të ashtuquajturin partneritet për Kosovën. Në raportin e Këshillit të Sigurimit të KB-ve është vënë në pah një progres jo aq i qëndrueshëm. Ndërsa pikërisht tani në kohën kur diskutohet e ardhmja e Kosovës, rezultatet konkrete në këtë fushë janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Në këtë kontekst, UE-ja parashikon dy sfida kryesore në të ardhmen a afërt:

- Së pari, pjesëmarrjen konstruktive në procesin e bisedimeve për status; dhe,
- Së dyti, përsheptimi i punës rreth plotësimit të standardeve dhe reformave kryesore evropiane.

Unë pata kënaqësinë të dëgjoj nga Kryeministri i ri i Kosovës përkushtimin e tij të qartë në këtë drejtim, në fjalimin e tij të mbajtur përpara deputetëve të Kuvendit me rastin e votimit për kabinetin e tij. Me këtë

rast, ishte inkurajues premtimi i tij për t'i afruar minoritetet dhe për t'iu faktuar atyre se në Kosovë ka vend për të gjitha komunitetet.

Për UE-në ekziston edhe sfida e tretë: që të përgatitemi për angazhimin tonë pas statusit, dhe pas largimit të UNMIK-ut. Në të ardhmen parashihet që UE-ja të jetë më shumë e angazhuar si në Kosovë, në terren, ashtu edhe në proceset rajonale të integritimeve evropiane, në përgjithësi. Kështu që, UE-ja do të jetë më e pranishme në Kosovë dhe Kosova do të jetë më e pranishme në UE.

Ne tanimë jemi duke u përgatitur gradualisht për prezencën tonë në Kosovë, si me personel diplomatik ashtu edhe me ekspertë në lëmin e sundimit të ligjit. Kështu që, gjatë kësaj pranvere në Prishtinë do të formohet ekipi për përgatitjen e misionit të ardhshëm të UE-së në fushën e policisë dhe gjyqësisë. Ky ekip do të ketë bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e Kosovës, përfshirë këtu ministrat e sapo krijuara të punëve të brendshme dhe të drejtësisë.

Ende është herët të përcaktohet forma e saktë e angazhimit të UE-së në Kosovë, ngase kjo do të varet nga zgjedhja e statusit. Ndonëse, filozofia (forma) e këtij angazhimi është e qartë:

- Qasja e UE-së është që ta shtojë deri në maksimum pronësinë e Kosovës në qeverisjen e vendit. Ngase janë autoritetet vendore - dhe jo bashkësia ndërkombëtare - ato që do ta bartin përgjegjësinë;



- UE-ja do të përpiqet t'i vijë në ndihmë Kosovës për t'i adresuar dy kategori kryesore sfidash. Së pari sfidat strukturore-ekonomike, administrative dhe teknike- që janë të përbashkëta me ato të rajonit. Pastaj, sfidat specifike - garancitë për të drejtat e minoriteteve, trashigëmia kulturore, decentralizimi, etj - që do të dalin nga dispozitat e marrëveshjes për zgjidhjen e statusit; dhe,
- Vizioni i UE-së do të jetë ndihma Kosovës për integritet evropiane. Në këtë kontekst, ministriat e UE-së kohëve të fundit në Strazburg kanë rikonfirmuar të ashtuquajturin premtim të Selanikut se në Evropë ka vend për vendet e Ballkanit Perëndimor kur ato t'i plotësojnë kushtet. S; këndejmi, ky premtim (zotim) vlen edhe për Kosovën, pra edhe për Presidentin Sejdiu dhe PSSP-ën Jessen-Petersen, të cilët morën pjesë së bashku në takimin e Strazburgut.

S'do mend se tani jemi të përqendruar rreth standardeve dhe statusit. Megjithatë, historia nuk do të ndalet në momentin që të gjendet zgjidhja për statusin e Kosovës. Pas kësaj do të hapet kaptina e re. Kjo kaptinë, nëse Kosova dëshiron dhe është e gatshme, mund të jetë rruga e Kosovës drejt UE-së dhe NATO-s. Ndonëse kjo rrugë nuk është e lehtë. Megjithatë, vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore kanë provuar se jo vetëm që vetë rrugëtimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm por edhe se arritja në cak është e mundur.

Shqyrtimi i Draft Ligjit për Veteranët: OSBE-ja ofron mbështetje

Jade Duchesneau-Bernier dhe Patrice Quesada, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Më 23 shkurt, të viti 2006, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin mbi Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Veteranëve, dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, si pjesë e legjislationit, që ka për qëllim lehtësimin e kushteve të rënda jetësore të atyre qytetarëve të afektuar drejtpërsëdrejti nga konflikti i armatosur. Në realizimin e kësaj, ka kontribuar edhe bashkëpunimi për një kohë të gjatë ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Misionit të OSBE-së në Kosovo.

Procesi ka filluar gati dy vite më parë, në qershor të vitit 2004, kur është paraqitur draft ligji për të parën herë, para Kuvendit. Megjithatë, për shkak të mangësive të shumta, nuk u lexua për herë të dytë. Draft ligji nuk u shqyrtua deri në janar të vitit 2005, kur atë e paraqiti përsëri qeveria e re, me ç'rast u përkrah nga Kuvendi menjëherë në shqyrtimin e parë. Që nga ky moment, deri në miratimin përfundimtar, në shkurt të vitit të kaluar, ky draft ka pësuar një varg amandamentimesh.

Ashtu sikundër kanë vepruar edhe palët e tjera të interesuara, si veteranët e luftës dhe organizatat e invalidëve, grupet parlamentare dhe UNMIK-u, edhe OSBE-ja e ka komentuar dhe i ka dhënë vërejtjet për draft ligjin. Deri atëherë, Komisioni funksional i Kuvendit është përballur me një detyrë të vështirë ti pajtojë (bashkërendojë) kërkesat kontradiktore dhe njëherazi të sigurojë shpalljen e ligjit jodiskriminues dhe perspektivën reale për zbatim e tij në tërësi. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë

gjendje të ndërlikuar, Misioni i OSBE-së i ofroi ekspertizë Kryetarit të Kuvendit të Kosovës në fund të shtatorit 2005. Kjo ofertë u pranua zyrtarisht më 7 tetor.

Involvimi i OSBE-së nuk synonte të luaj rol të drejtpërdrejtë në ri-hartimin e ligjit apo të thoshte fjalën e fundit në amandamentimin e nevojshëm, por disi ti inkurajonte ligjvënësit, që ti adresoheshin shqetësimeve të pikave më të ndieshme të shoqërisë në mënyrë pragmatike dhe përkrahëse. S'ka pikë dyshimi se në Kosovë gjendja e pas konfliktit, ku shumica e popullatës vuan nga kushtet e rënda sociale dhe ekonomike, çështja e të drejtave të veteranëve të luftës dhe beneficioneve të tyre konsiderohen si çështje shumë të ndjeshme.

Ligji kroat për veteranët e luftës, është cituar shumë dhe konsiderohet si shembull pozitiv nga rajoni, ndaj është shfrytëzuar si model nga hartuesit e ligjit të Kosovës për veteranët e luftës. Së këndejmi, OSBE-ja doli me idenë që të sigurojë shërbimet e një eksperti kroat, që ta ndihmojë Komisionin e Kuvendit rreth punës për shqyrtimin dhe amandamentimin e këtij draft ligji. Ndërsa, falë bashkëpunimit të Ministrisë kroate për punë të jashtme dhe integritet evropiane, shumë shpejt u identifikuar kandidati i përshtatshëm për këtë punë: z. Marijan Pokrajčić. Si një zyrtar i lartë i Ministrisë kroate për punë dhe mirëqenie sociale, ai ka qenë mjaft i involvuar në hartimin e ligjit kroat për veteranët e luftës dhe legjislationin suplementar të tij.

Brenda periudhës katër javore,

ai e ka shqyrtuar dhe i ka dhënë vërejtjet për draft ligjin e Kosovës për veteranët e luftës. Ndërsa, në dhjetor në fund të qëndrimit të tij, ai prezantoi një përmbledhje të vërejtjeve dhe shqetësimeve të tija para deputetëve të Komisionit funksional të Kuvendit. Shumica syresh janë marrë parasysh nga Komisioni me rastin e procedimit, shqyrtimit dhe amandamentimit të draft ligjit. S'ka pikë dyshimi se përmes këtij procesi intensiv të amandamentimit, ligji është përmirësuar dukshëm në krahasim me versionet e mëparshme. Ndonëse, disa aspekte të caktuara të ligjit mbetën akoma problematike.

Miratimi i ligjit paraqet një hap përpara, të institucioneve të Kosovës drejt marrjes së përgjegjësive për adresimin e nevojave të kësaj kategorie të rëndësishme shoqërore. Pas shpalljes së tij do të fillojë faza më e rëndësishme: zbatimi. Në të ardhmen, këtë proces e presin ende sfida të rëndësishme, ndonëse zbatimi i tërësishëm i këtij ligji do të varet në masë të madhe jo vetëm nga legjislationi suplementar, që duhet të nxirret nga ministritë e ndryshme, por edhe nga disponueshmëria e mjeteve buxhetore.

Që nga përfundimi i luftës Misioni i OSBE-së në Kosovë, ka zhvilluar dialog të frytshëm me organizatat e veteranëve dhe invalidëve të luftës dhe ka ofruar mbështetje e vet si për të siguruar ri-integrimin e tyre në shoqëri ashtu edhe për përmirësimin e kushteve sociale. Për më tepër, OSBE-ja është e gatshme që madje t'i ofrojë ndihmë Institucioneve të Përkohshme edhe gjatë fazës kryesore të zbatimit të këtij ligji.

Aspektet kryesore të “kohës së parashikuar për pyetje”

David Payne, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)



David Payne

E drejta për të kërkuar informata nga një ministër qeveritar dhe e drejta për ta mbajtur atë zyrtarë përgjegjës para Kuvendit njihen si dy parimet themelore të qeverisjes parlamentare. Deputetët e Kuvendit zakonisht i ushtrojnë këto të drejta, duke parashtruar pyetje në Kuvend gjatë kohës zyrtare të parashikuar për “parashtrimin e pyetjeve”. Së këndejmi, kërkesat apo sqarimet rreth informatave përmes pyetjeve përbën jo vetëm një ndër aspektet qenësore të punës dhe veprimtarisë së deputetëve por ka rol qendror në strategjinë parlamentare. Pyetjet zakonisht parashtrohen pa paralajmërim, duke kërkuar përgjigje spontane, por ndonjëherë ato edhe dorëzohen paraprakisht me shkrim.

Qeveria propozon dhe opozita kundërshton thotë thënia tradicionale për parlamentet kudo në botën demokratike. Tanimë janë pjekur kushtet që pyetjet të parashtrohen si pjesë normale e seancave të rregullta të Kuvendit të Kosovës. Rregullorja e Punës përmban dispozita lidhur me këtë çështje. “Koha për parashtrimin e pyetjeve” është një kohë e rezervuar për pyetje me gojë, nga ana e deputetëve të opozitës-ndonëse

jo ekskluzivisht nga ta dhe për përgjigjen e ministrave në ato pyetje. Ministri ndonjëherë paralajmërohet para fillimit të seancës se ka intenca që ndonjë deputet të bëjë pyetje, duke mos e njoftuar ministrin patjetër për formulimin e saktë të saj. Mirëpo, ka edhe raste kur nuk është e thënë që ministrat të paralajmërohen për pyetje të mundshme, ngase lajmet, ngjarjet e paparashikuara dhe rastësitë, shpeshherë diktojnë në mënyrë të pashmangshme domosdoshmërinë e parashtrimit të ndonjë pyetje.

Pyetja duhet t’i drejtohet ministrit të caktuar, sekretarit të parlamentit apo kryeministrit. Kryeministri mund t’ia lë në përgjegjësi përgjigjen në pyetje njërit prej ministrave. Pyetja duhet të jetë e shkurtë, zakonisht jo më e gjatë se një minutë e pasuar me përgjigje me kohëzgjatje të ngjashme. Ndërsa, ministri pastaj duhet të këshillohet rreth dosjeve që duhen konsultuar dhe të ofrojë përgjigje bindëse aty për aty. Mediat në përgjithësi parapëlqejnë të marrin pjesë në seancat ku parashtrohen pyetje, ngase ky është rasti kur çështjet e ngritura mund ose ta turpërojnë apo edhe forcojnë kredibilitetin e qeverisë, dhe ku një deklaratë me vend mund të ndikoj në mendimin e publikut përmes aftësive të mprehta oratorike apo shkathtësive të mprehta parlamentare. Minis-tri ka mundësi të zgjedh në vonimin e përgjigjes dhe të përgjigjet në atë pyetje më vonë. Mirëpo, pavendosmëria e ministrit mund të ndikojë negativisht në imazhin e tij/saj. Së këndejmi, ministri i cili nuk mund t’ia dalë mbanë të përgjigjet në pyetjet e shtruar me vend dhe

me mençuri do të ketë jetë të shkurtër politike.

Ministrat zakonisht duhet të jenë prezent gjatë kohës kur bëhen pyetjet, ngase kjo është pjesë normale dhe e domosdoshme e mbikëqyrjes parlamentare dhe ekzekutive. “Les absents ont toujours tort!” ose “Mungo në rrezik tëndin!” Ndaj, madje edhe në mungesë të ministrit, mund të i parashtrohen pyetje (në vend të tij/saj) kryeministrit apo ministrit tjetër. Zakonisht pyetja nuk refuzohet nga kryetari për shkak të mungesës së ministrit.

Ndonëse, sipas rregullores së punës është e ndaluar të parashtrohen pyetje, që do të provokonin debate apo që përmbajnë insinuata, Kryetari i Kuvendit megjithatë edhe në këso raste duhet të bëjë çmos që ta mbajë rendin dhe qetësinë. Ngase një pyetës i shkathtë mund ta përdor ironinë, patosin, epitetin, që të arrijë efektin e dëshiruar. S’do mend se Qeveritë zakonisht tregohen të matura gjatë kohës së parashtrimit të pyetjeve. Madje, për këtë ekziston edhe një rregull e pashkruar në traditën parlamentare britanike sipas së cilës: opozita duhet të favorizohet në frymën/cilësinë e “humbësit”, ngase koha për pyetje është një moment ku opozita është e privilegjuar, sepse mund ta kundërshtojë dhe të kërkojë llogari nga qeveria para opinionit.

Qeveria ndonjëherë ka pësuar dëme serioze nga përpjekjet e përbashkëta të opozitës për ta dobësuar integritetin e qeverisë përmes pyetjeve të pamëshirshme dhe të hulumtuara mirë. S’do mend se një qeveri e re dhe e papërvovjës është

e ndjeshme. Veç kësaj, koha e pyetjeve shpesh karakterizohet me fyerje, tallje, skena teatrale dhe ofendime të rënda verbale, ndaj është sfidë për cilindo Kryetar. Krerët e grupeve parlamentare do të insistojnë tek grupet e tyre parlamentare se garancia më e mirë për vlerësimin e publikut është shkëmbimi me dinjitet, i matur dhe i kulturuar midis ministrit dhe opozitës. Shpeshherë edhe pa rezultate.

Rregulla themelore për partitë opozitare është, që askurrë mos të bëjnë pyetje pa e ditur paraprakisht përgjigjen. Opozita synon ti shfrytëzojnë dobësitë e ministrave të dobët me shpresë, që të fitojnë më shumë kohë transmetimi në media, përderisa qeveria përpiket ta spostojë vëmendjen nga çështjet potencialisht problematike. Por, koha e pyetjeve po ashtu paraqet një rast ideal për ministrat e qeverisë që t’i prezantojnë lajmet e mira për të arriturat e tyre, dhe të shpotiten me naivitetin dhe injorancën e opozitës. Sidoqoftë, parashtrimi i pyetjeve vetëm sa bën të mundur që të fuqizohet dhe avancohen si demokracia parlamentare ashtu edhe përgjegjësia qeveritare. Një balancë kjo e domosdoshme për krijimin e një demokracie të mirëfilltë. Pa një kohë të rezervuar për parashtrimin e pyetjeve Kuvendi nuk mund të jetë plotësisht i hapur dhe demokratik. Ky është një standard të cilin mëtojnë ta arrijnë të gjitha parlamentet me demokraci të vërtetë.

Para se të fillojë të punojë në NDI, David Payne ka shërbyer si deputet i Parlamentit kanadez, sekretar parlamenti për tre kryeministrat e Quebec-ut dhe si Komisioner për Tregti në Kinë.

Prezenca e OSBE-së në terren

Kara Johnston-Molina, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Qeverisja demokratike ka të bëjë me funksionim e drejtë të institucioneve e sidomos me marrjenepronësisë,përgjegjësi dhe llogaridhënies nga ana e vendorëve. Së këndejmi, parimet bazë të politikës së UNMIK-ut janë që të mbështesin IPVQ-ët në respektimin dhe përmbushjen e standardeve, të drejtave të njeriut, legjislacionit të aplikueshëm, rregullores së punës dhe normave të tjera, e posaçërisht ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve pakicë.

Transferi i përgjegjësi dhe kompetencave tek IPVQ-ët- kjo kohëve të fundit më së miri mund të vërehet me krijimin e ministrive të reja, në kuadër të IPVQ-ve, Ministrisë së punëve të brendshme dhe asaj të drejtësisë, në kuadër të rezolutës 1244- ka bërë të mundur që nga zyrtarët e IPVQ-ve të kërkohet më tepër përgjegjësi për veprimet e tyre në të gjitha rrafshet. Premisa kryesore e politikës së UNMIK-ut është që IPVQ-ët të monitorohen dhe inkurajohen që të ndërmarrin veprime korrektuese në rastet kur paraqitet nevoja, ndërsa afër mendsh UNMIK-u e rezervon të drejtën që të intervenojë në instancën e fundit. Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK), është duke punuar mjaft aktivisht rreth politikave monitoruese me qëllim që të inkurajojë marrjen e masave preventive dhe “vetë korrigjuese”, duke e bërë një riorientim të vogël të aktiviteteve të veta dhe duke e shtuar prezencën në terren. Së këndejmi, Misioni i OSBE-së në Kosovë është duke bashkëpunuar në bazë multilaterale me partnerët e vet - si Unioni Evropian dhe Kombet

e Bashkuara- rreth planifikimit të së ardhmes sonë.

Për të qenë sa më efikas në rolin monitorues, Misioni i OSBE-së në Kosovë duhet të jetë prezent në 30 komuna si dhe në pilot njësitë komunale. Kjo do të thotë se Misionit të OSBE-së në Kosovë i është dashur ta forcojë prezencën në terren. Kështu që, së shpejti OSBE-ja do të jetë organizata e vetme në Kosovë me një strukturë të zgjeruar në terren: me ekipe komunale në secilën nga 30 komunat dhe tri pilot njësitë komunale. Kjo nënkupton bartje të përgjegjësi nga Departamenti i Administratës Civile tek Misioni i OSBE-së në Kosovë, ngase këto dy institucione punojnë bashkërisht për të bërë një dorëzim pranimit sa më të lehtë dhe pa pengesa të funksioneve dhe përgjegjësi, ndërsa UNMIK-u “largohet”. Në nivelin lokal, UNMIK-u dhe DAC-i bashkëpunojnë në monitorim, raportim dhe analizim si dhe në ofrimin e rekomandimeve për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për intervenime dhe ndërhyrje në ekzekutiv.

Secili ekip monitorues i Misionit të OSBE-së (një në secilën nga komunat si dhe tri të tjera të caktuara për pilot njësitë komunale) përbëhen nga një zyrtar vendor dhe ndërkombëtar të demokratizimit, që bashkëpunojnë me ekipet me përbërje të ngjashme të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit. Ndërsa, stafi merr udhëzime nga zyrtarët e lartë, ngase Misioni i OSBE-së ka nga një zyrtar të lartë për secilën Qendër rajonale të OSBE-së në terren. Ekipet komunale të Misionit të OSBE-së në Kosovë janë “sy të dhe veshët” e

gjithë Misionit, dhe përqendrohen më tepër në analizat që dalin nga monitorimi aktiv dhe në mbështetjen e IPVQ-ve.

Vlen të vihet në dukje se Zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në UNMIK mbështetet

shumë në prezencën e fuqishme në terren për të vlerësuar zbatimin e standardeve dhe për të implementuar një politikë të përgjegjshme. Së këndejmi, detyrë kryesore e tyre është që t'i kandisin (bindin) zyrtarët e IPVQ-ve që të veprojnë dhe punojnë në pajtim me përgjegjësitë, kompetencat si dhe standardet dhe ligjet e aplikueshme. Ndaj këto mund të përdoren jo vetëm për t'i vënë në pah sukseset por edhe për t'i theksuar pengesat dhe mangësitë ligjore dhe procedurale për sigurimin e të drejtave njerëzore, ekonomike, sociale dhe politike për të gjithë qytetarët pa dallim. Si pjesë e UNMIK-ut, Misioni i OSBE-së mbështetet në IPVQ-të dhe në të gjitha partitë politike, në të gjitha nivelet, përfshirë komunat për të marrë masa ndaj pakënaqësive të tilla në rastet kur ato paraqiten, dhe për të siguruar se shërbyesit civil punojnë në pajtim me ligjin. S'ka pikë dyshimi se UNMIK-u është i gatshëm që të veprojë dhe reagojë, bazuar në politikën dhe përgjegjësitë që ka, në rast se IPVQ-ët dhe komunat nuk veprojnë në përputhje me obligimet që kanë. Tekembramja ky është mandati i tij.

Suksesi i politikës së llogaridhënies mbështetet jashtëzakonisht shumë në faktin se Misioni i OSBE-së me prezencën e vet të zgjeruar në terren është



Ismet Beqiri, Kryetari i Kuvendit Komunal të Prishtinës

shumë mirë i integruar me pjesën tjetër të UNMIK-ut në Kosovë. Prandaj, koordinimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të siguruar një qasje të qëndrueshme në gjithë Misionin, e sidomos në terren. S'do mend se me afrimin e zgjidhjes së statusit nevoja për koordinim do të shtohet, ndaj dhe ne kemi filluar të kalojmë në marrëveshje ndërkombëtare post-statusore.

Në fazën post-statusore (dhe mbase pas largimit të UNMIK-ut), OSBE-ja do të ketë një rol të pavarur dhe mbase nga ne do të kërkohet që të marrim rolin kryesor të prezencës ndërkombëtare në Kosovë. Kjo duhet të shfrytëzohet në mënyrë optimale për të monitoruar zbatimin e statusit të ardhshëm - cilido që të jetë ai - e që ka të bëjë me nivelin lokal gjatë vitit 2006. Së këndejmi, roli i Misionit të OSBE-së në Kosovë duhet të reflektojë dhe ta ruajë pjesëmarrjen në strukturën ekzistuese të prezencës ndërkombëtare, duke bërë të mundur njëherësh që ta vazhdojë punën e vet edhe në strukturën e ardhshme. Sido që të jetë, dhe pavarësisht nga rezultatet e bisedimeve për status, Misioni i OSBE-së në Kosovë angazhimin e vet do ta përqendrojë në krijimin e një sistemi demokratik dhe të një shoqërie multi-etnike të qëndrueshme në Kosovë.

Përkthimi me shkrim/me gojë:

Sfidat aktuale të përkthimit

Lirak Karjagdiu, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Askurrë në historinë e njerëzimit nuk ka pasur aq shumë njerëz të angazhuar në veprimtarinë përkthyesë se sot. Me qindra mija përkthyes dhe interpretë, pothuajse për ditë, me veprimtarinë e tyre humane dhe të paepur, i ndihmojnë komunikimit ndërnjerëzor, komunikimit ndërnjerëzor, gjuhësor, shoqëror, politik, kulturor, artistik, shkencor dhe të mjetëve të komunikimit masiv midis popujve dhe shteteve të ndryshme. Roli i interpretëve dhe përkthyesve në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, në këmbime ekonomike, tregtare apo afariste, në përhapjen e kulturës, artit, filmit dhe shkencës, është i stërmadh. Në epokën tonë, nuk mund të merret me mend mbajtja, organizimi, funksionimi dhe suksesi i asnjë konference, samiti, kongresi, simpoziumi, takimi apo sesioni profesional, ndërkombëtar, shkencor, politik, diplomatik apo kulturor, pa pjesëmarrjen, impenjimin dhe misionin fisnik të interpretëve dhe përkthyesve. Me një fjalë, përkthimi është bërë jo vetëm kusht i komunikimit të ndërsjellë, por edhe cytës i progresit, bashkëpunimit, mirëkuptimit, tolerancës, miqësisë, paqes dhe fatit tonë.

Edhe në Kosovë, sidomos pas hyrjes së trupave të NATO-s dhe instalimit të administratës ndërkombëtare janë angazhuar, punësuar dhe ushtrojnë misionin e detyrën e interpretit dhe përkthyesit me dhjetëra e qindëra veprimtarë të rinj të përkthimit. Ata punojnë jo vetëm në zyrat,

agjencitë dhe përfaqësitë e KFOR-it, UNMIK-ut dhe OSBE-së, po edhe në qendra të lidhjes, qendra diplomatike, agjenci, institucione, përfaqësi ekonomike, turistike, politike, publicistike, shoqata të llojllojshme humanitare, shëndetësore, edukuese, kulturore, etj. Me veprimtarinë e tyre të palodhshme, ata e bëjnë të mundur komunikimin midis përfaqësuesve, politikanëve, diplomatëve, ekspertëve, krerëve, udhëheqësve dhe nëpunësve të huaj dhe vendorë. Së këtejmi, mbase edhe pa qenë gjithaq të vetëdijshëm, ata i kontribuojnë para së gjithash komunikimit të ndërsjellë, pastaj mirëkuptimit mes dy palëve, bashkëpunimit, thellimit të miqësisë dhe, ç'është më esenciale, transferimit dhe transmetimit të përvojës organizative, institucionale, legjislativë, shkencore, profesionale, kulturore, shtetformuese e demokratike të ekspertëve të huaj, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën e pakicave.

Por, për fat të keq edhe në Kosovë veprimtaria e përkthimit, ndonëse para luftës, në përgjithësi është ushtruar nga disa përkthyesë të talentuar dhe me përvojë, pas luftës së fundit në Kosovë (1999), për shkak të shtimit të përnjëhershëm dhe të jashtëzakonshëm të nevojës dhe interesimit si për përkthime me shkrim ashtu edhe për interpretime me gojë, me përkthime kanë filluar të merren dhe po merren siç thotë Vedat Kokona edhe përkthyes nga halli dhe përkthyes nga

malli. "Janë nga malli" sqaron Kokona, "ata që Nëna Natyrë i ka thirrur dhe porositur që të punojnë ashtu si i ka thirrur dhe porositur Ajo dhe jo ndryshe". S'do mend, se Nëna Natyrë është dhuntia, talenti, prirja, ndoshta që në ngjizje. Cila është kjo dhunti? Pasioni për të lexuar, kuptuar, përvetësuar dhe transmetuar një tekst, mesazh, ide, mendim në mënyrë sa më të qartë, të kthjellët, lucide dhe origjinale. Ndërkaq, përkthyes nga halli, sipas Kokonës, "janë ata që, pa u pagëzuar me ujin e "Thirrjes" dhe pa dashur të bëjnë një punë tjetër, që mund ta bëjnë, por që s'e bëjnë dot se ajo do mundin, hidhen në një valle ku kërcejnë arithi sa bëhen të dëmshëm dhe qesharakë". Këta lloj përkthyesish janë ata që pothuajse nuk kanë asnjë dhunti, talent, kulturë, parapërgatitje, apo prirje për përkthim, janë dembelë që pandehin se gjëja më e lehtë në botë është të përkthesh. Mjerisht, dendur ata nuk i dalin zot detyrës si duhet, por më e keqja është se e cenojnë tekstin dhe porosinë, duke e dëmtuar kështu jo vetëm stilin, por edhe duke e çinformuar lexuesin apo dëgjuesin.

Përveç kësaj, sipas Edmond Tupjes, një ndër teoricientët e përkthimit dhe përkthyesit të shquar shqiptar, pos përkthyesve nga malli ose përkthyesve të mirëfillët e të talentuar në mesin e përkthyesve nga halli, dallohen edhe dy kategori të tjera: nënpërkthyesit dhe pseudopërkthyesit. Sipas tij, "të

parët janë të ndërgjegjshëm, punëtorë e modestë dhe përiqen të shfrytëzojnë maksimumin e mundësive të tyre, por u mungon dhuntia, talenti, prirja dhe aftësia; rrjedhimisht, përkthimet e tyre janë mediokre, kanë nevojë të bëhen qilizmë (ripërkthehen) nga një përkthyes i vërtetë dhe, me këtë rast, redaktori kthehet detyrimisht në bashkëpërkthyes. Të dytët, pseudopërkthyesit, janë pikërisht ata që i përshkruan Vedat Kokona, d.m.th. ata nuk kanë as dhunti, as dije dhe as dëshirë për të punuar. "Kjo specie", vëren ai, "është më e përhapura sot te ne, si në mediat e shkruara dhe ato elektronike, ashtu edhe në tërë fushat e tjera ku ka nevojë për përkthime, madje edhe në lëmin e përkthimeve letrare."

S'ka dyshim se një sfidë tejet e madhe është edhe niveli shpeshherë i pamjaftueshëm, për të mos thënë i cekët, jo vetëm i përkthimit me shkrim, i teksteve, shkresave administrative, broshurave, etj, por edhe interpretimit apo përkthimit simultan dhe konsektiv nëpër konferenca, seminare, trajnime dhe ngjarje të tjera të rëndësishme si me karakter kombëtar e shoqëror ashtu edhe me karakter rajonal, evropian dhe ndërkombëtar. Mirëpo, kur është fjala për përkthimet me shkrim, për shkak të natyrës së këtij lloji të përkthimit, përkthyesit kanë mundësi që t'i përmirësojnë, revidojnë dhe korrigjojnë përkthimet e tyre qoftë vetë qoftë përmes lektorëve, ndërsa

kur është fjala te interpretimi, kjo është pothuajse pamundur. Si rrjedhojë, herë herë ndodh që për shkak të përkthimit të dobët të dështojnë ngjarje të caktuara. Në disa raste të tjera ka ndodhur që për shkak të përkthimit të paqartë dhe konfuz interlokutorët nuk e kanë kuptuar njëri tjetrin. Ka edhe situata ku për shkak të cilësisë së dobët të përkthimit me gojë bashkëbiseduesit krijojnë një pasqyrë të shtrembëruar mbi nivelin, seriozitetin dhe kompetencën intelektuale dhe profesionale të njëri-tjetrit. Zakonisht, situata të këtilla paraqiten edhe për shkak të papërgjegjësisë së organizatorëve të ngjarjeve, mosdisiplinës së folësve, ligjëritimit të mangët dhe gjuhësisht të pasaktë të një folësi, mosnjohjes së terminologjisë, lëndës, sintaksës dhe stilit të të dy gjuhëve, qëndrimit përcmues të tyre ndaj përkthyesve dhe përkthimit, në veçanti, etj. Prandaj, për t'i evituar situatat e këtilla pikë së pari folësi duhet të ketë parasysh se flet përmes përkthyesit, dhe nëse fjalimi i tij/ saj është konfuz, i vagulluar dhe i mungon rendi i qartë dhe logjik, atëherë edhe përkthyesi deshi apo s'deshi do ta transmetojë dhe përçojë porosinë në mënyrë konfuzë dhe të paqartë. Pos kësaj, folësi duhet ta kontrollojë edhe ritmin ose tempon e të folurit. Ai duhet të flasë me një shpejtësi, ton dhe zë normal, nga një anë dhe brenda mundësive të verifikojë sesi po e përcjellë atë përkthyesi, nga ana tjetër. Gjatë ngjarjeve të ndryshme nuk lejohet që të flasin shumë pjesëmarrës njëkohësisht, ngaqë interpretët nuk mund t'i përkthejnë disa folës njëkohësisht. Njëherit, pjesëmarrësit është e udhës që t'u shmangen përdorimit të fjalive të gjata dhe komplekse dhe në

vend të kësaj të përdorin fjali të shkurtëra dhe kuptimplota. Përpos kësaj, folësit duhet t'i shqiptojnë fjalët drejtë dhe me korrektësi, ngase disa fjalë jo vetëm në gjuhën angleze, por edhe në gjuhë të tjera kanë shqiptim shumë të ngjashëm dhe nëse nuk shqiptohen mirë dhe me korrektësi mund të keqkuptohen. Një çështje tjetër që duhet ta kenë parasysh folësit, të cilët flasin përmes përkthyesit është edhe evitimi i përdorimit të zhargoneve, akronimeve, idiomave, metaforave, frazeologjizmave, meseleve dhe humorit, sepse këto shpeshherë i japin përkthimit nuancë të gabuar.

Një lehtësi, ndihmesë dhe mirëkuptim për interpretët, mund të japin organet apo institucionet gjuhësore ku punojnë përkthyesit nëse atyre u bëjnë të mundur që të:

1. Informohen me kohë për rendin e ditës së takimit, qëllimin e takimit, përmbytjen e fjalimeve;

2. Informohen mbi atë se sa është i rëndësishëm takimi dhe për nivelin e pjesëmarrësve;
3. Përcaktohen dhe informohen për llojin më adekuat dhe më të preferuar të përkthimit për ngjarjen (konsekutiv apo simultan);
4. Sigurohet një liste e termave teknikë, dhe të specializuar si dhe të akronimeve që mund të përdoren gjatë takimit;
5. Sigurohen kopjet apo skicat e fjalimeve apo prezantimeve;
6. Takohen me organizatorin para fillimit të ngjarjes me qëllim që organizatori t'u përgjigjet pyetjeve që përkthyesit mund të kenë rreth terminologjisë, frazeologjisë, mënyrës së organizimit dhe zhvillimit të takimit, etj.

Tekefundit, transparenca dhe suksesi i interpretimit apo përkthimit me gojë, në përgjithësi varet shumë nga kualiteti dhe kuantiteti i përgatitjeve

që bëhen para takimeve, e në veçanti nga përgatitja, trajnimi, shkollimi dhe formimi i përkthyesve.

Në këtë mes, një rol të rëndësishëm mund të luajnë degët e gjuhëve dhe letërsive të huaja të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, e veçanërisht Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, të cilat në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovës mund të dërgojnë përkthyes të talentuar për specializim jashtë vendit. Kohë më parë është hedhur edhe një ide për themelimin e Institutit për Përkthime, i cili me ndihmën dhe përkrahjen e ndërkombëtarëve, nënëfunddo të bënte të mundur shkollimin, përgatitjen, aftësimin dhe formimin e përkthyesve dhe interpretëve profesionistë të nivelit ndërkombëtarë. Kujtoj që një ide e tillë është shumë e qëlluar dhe e dobishme sidomos tani kur Kosova është duke u përgatitur për integrim euroatlantike.





Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinatori i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombëtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Franklin De Vrieze, Chris Cycmanick, Blerim Vela, Labinot Hoxha, Edmond Efendija, Krenar Loshi.

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
http://www.osce.org/kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :

OSBE-ja: fq. 2, 17, 14, 26 • Gazeta Ditore Ekspres: fq. 1, 2, 20
(Visar Kryeziu) fq. 3, 7, 11 (Ermal Meta) fq. 5, 9, 13, 16 (Astrit Ibrahim) fq.10 (Ferdi Limani) fq. 25 (Fisnik Dobreci) • Departamenti për Informim Publik (DPI) pranë UNMIK-ut: fq. 18 • Kuvendi i Kosovës: fq. 14, 15. • IDN(NDI): 24.